

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5758  
E shtunë, 20 prill 2019  
çmimi 0.40 €

## Tri subjekte politike kanë aplikuar për zgjedhjet në veri



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA | FAQE 4-5

## Koalicioni ka mundur të funksionojë edhe më mirë

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka vlerësuar se koalicioni qeverisës ka mundur të funksionojë edhe më mirë, por është ballafaquar me mungesë të numrave në Kuvend. Megjithatë, ai ka thënë se opozita nuk i ka numrat për ta rrëzuar qeverinë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se problemi është se nëse shkohet në zgjedhje në këtë kohë sa mund të përmirësohet situata. Prandaj, sipas tij, partitë duhet të diskutojnë për kohën se kur duhet të mbahen zgjedhjet. Berisha ka folur edhe për dialogun me Serbinë, për të cilin proces ka thënë se është në rrugë të gabuar. Për të pasur sukses ky proces, ai ka thënë se faktori politik duhet të bashkohet në qëndrime, në të kundërtën këto bisedime bartin rreziqe serioze për Kosovën dhe rajonin



### AKTUALE

**NIS PUNA PËR DRAFTIMIN  
E LIGJIT QË NDËSHKON  
MOHIMIN E KRIMEVE TË  
KRYERA GJATË LUFTËS  
NË KOSOVË** F. 7

**PRESIDENTI THAÇI PËR  
BATALIONIN 'ATLANTIKU':  
MISIONIN PËR ATDHEUN E  
KREU BALLËHAPUR** F. 5



### EKONOMI

**VALA TV PËR SHTATË DITË  
ARRIN 150 MIJË SHKARKIME**

F. 8

**VESELI: DO T'I RRSIM  
SUBVENCIONET PËR TË  
GJITHË FERMERËT  
E KOSOVËS** F. 8



### SPORT

**2 700 FËMIJË SHIJOJNË  
SPORTET NË 'FADIL VOKRRI'**

8



## Kosova dhe Serbia, larg normalizimit të marrëdhënieve

FAQE 3

Instituti Demokratik i Kosovës dhe njohësit e rrethanave politike kanë theksuar se Kosova dhe Serbia janë larg normalizimit të marrëdhënieve. Në gjashtëvjetorin e marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënies Kosovë - Serbi, KDI-ja ka vlerësuar se mungesa e zbatimit të plotë të kësaj marrëveshje nuk ka arritur t'i përmbushë pritshmëritë e qytetarëve. Ndërsa politologu Belul Beqaj ka deklaruar se procesi i



dialogut në mes të dy vendeve për marrëveshjen përfundimtare është larg qëllimeve të paralajmëruara



**Malisheva,  
Suhareka, Rahoveci  
dhe Klina, komunat  
më të prekura nga  
pickimi i rriqrave**

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.P.A.  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Nesër në Maqedoninë Veriore mbahen zgjedhjet presidenciale



**SHKUP, 19 PRILL** - Në Maqedoninë Veriore të premten është mbyllur fushata për zgjedhjet presidenciale e nga mesnata ka nisur heshtja zgjedhore.

Kandidati i përkrahur nga Aleanca e Shqiptarëve dhe "Besa", Blerim Reka, e përfundoi fushatën e tij me tubimin e një ditë më parë në Tetovë, ndërsa ai i LSDM-së dhe koalicionit qeverisës, Stevo Pendarovski, e mbylli të premten me mitingje në Strugë e Ohër.

Sot (e shtunë), një ditë përpara zgjedhjeve, të drejtën e tyre të

votës mund ta realizojnë 1 640 persona në burgjet e vendit dhe persona që janë në arrest, shtatë të shpërngulur brenda vendit, si dhe gati 3 600 të sëmurë e të moshuar të cilët këtë e kanë kërkuar nga komisionet komunale zgjedhore.

Marrëveshja e Prespës, emri i ri i shtetit, anëtarësimi në NATO dhe në BE, zhvillimi ekonomik, raportet ndëretnike dhe politikat për rininë ishin temat kyçe të fushatës presidenciale në Maqedoninë e Veriut. Në paraqitjet para qytetarëve,

Pendarovski e vuri theksin në mënyrë të veçantë te marrëdhëniet ndëretnike. Por mbështetje nga etnitë e tjera kërkoi edhe Gordana Davkova, kandidatja e përkrahur nga opozita.

Për Blerim Rekën, në Maqedoninë e Veriut duhet të ketë koncept për shtet e jo vetëm për shoqëri për të gjithë. Nesër (e diel) qytetarët maqedonas do të votojnë për njërin nga tre kandidatët për president, ndërsa më 5 maj është raundi i dytë i votimit kur edhe zgjidhet presidenti i ri i vendit.

## Shanahan: Jemi partnerë të fortë me Shqipërinë, Rusia rrezik

Vizita në Uashington e ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka dhe takimi me sekretarin e Mbrojtjes në detyrë, Patrick Shanahan, nxori në pah shqetësimin rreth ndikimit rus në rajon. Sekretari Shanahan tha se kjo është një nga arsyet kryesore pse po takohemi, duke cekur se është rrezik, ndaj jemi partnerë të fortë



**UASHINGTON, 19 PRILL** - Sekretari i Mbrojtjes në detyrë, Patrick Shanahan, priti në Pentagon ministren e Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka, takim që riafirmoi marrëdhëniet e rëndësishme në fushën e mbrojtjes në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Shanahan-Xhaçka diskutuan rreth një game të gjerë çështjesh, përfshirë kontributin e rëndësishëm të Shqipërisë në operacionet e ShBA-së dhe NATO-s në rajon dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm për t'i luftuar aktivitetet malinje të Rusisë në Ballkan. Në takim u radakord mbi rëndësinë e ndarjes së barrës së shpenzimeve brenda aleancës. Sekretari Shanahan vlerësoi përpjekjet e Shqipërisë për ta arritur qëllimin e samitit të Uellsit, duke pëmbushur objektivin që lidhet me shpenzimet e mbrojtjes deri në vitin 2024.

Vizita në Uashington e ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta

Xhaçka dhe takimi me sekretarin e Mbrojtjes në detyrë, Patrick Shanahan, nxori në pah shqetësimin rreth ndikimit rus në rajon. Si përgjigje ndaj pyetjes së "Zërit të Amerikës", sekretari Shanahan tha se rreziku që paraqet Rusia në Ballkan është një nga arsyet kryesore të zhvillimit të këtij takimi. "Kjo është një nga arsyet kryesore pse po takohemi sot. Është rrezik, ndaj jemi partnerë të fortë", tha Shanahan, ka njoftuar voa.

Në komentet e tij në fillim të takimit, Shanahan vlerësoi bashkëpunimin e fortë mes dy vendeve duke përmendur, ndër të tjera, angazhimin e Shqipërisë me trupa në Afganistan apo objektivin e shpallur nga pala shqiptare në kuadër të NATO-s për të paguar 2 për qind të produktit të saj të brendshëm bruto për mbrojtjen. "Marrëdhënia mes dy vendeve është e fortë. Dua t'ju falënderoj për kontributin dhe

faktin që keni qenë një aleat model", shtoi Shanahan.

Kjo është vizita e dytë brenda një viti e ministres shqiptare të Mbrojtjes Olta Xhaçka. Gjatë kësaj vizite u njoftua marrëveshja e arritur me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes në funksion të modernizimit të forcave ajrore shqiptare, e cila parashikon marrjen e disa helikopterëve "Black Hawk". Fillimisht Shqipëria do të marrë tre helikopterë. Një tjetër projekt lidhet me rritjen e aftësive kibernetike të Shqipërisë.

Xhaçka tha se ShBA-ja ka qenë gjithmonë një mike e madhe dhe

aleate e popullit shqiptar dhe se pa mbështetjen dhe angazhimin bujar të saj, siç tha ajo, fati i rajonit do të kishte qenë shumë ndryshe. "Më lejoni ta shpreh mirënjohjen e Qeverisë shqiptare për administratën e amerikane për të qëndruar në mënyrë të vendosur me ne, në reformat kryesore që po ndërmarrim për të ndërtuar institucione më të forta demokratike dhe për ta forcuar sundimin e ligjit. Veçanërisht për reformën në sistemin tonë të drejtësisë, i cili është vendimtar për procesin e pranimit në BE", tha ajo. "Së fundi, por sigurisht jo për nga rëndësia, shpresojmë që

brenda këtij viti t'i nisim punimet në bazën e parë ajrore të Aleancës në rajonin tonë, në Kuçovë, një zhvillim që besoj se e njeh rolin e Shqipërisë si një spirancë e stabilitetit në rajon dhe rrit rëndësinë tonë strategjike për Aleancën në tërësi", tha Xhaçka.

Duke iu referuar bazës në Kuçovë, ministrja Xhaçka tha se ky është një zhvillim shumë i rëndësishëm për një rajon që në vitet e fundit është bërë një pikë e nxehtë e rivaliteteve gjeopolitike dhe dëshmitar i një përpjekjeje shumë të bashkërenduar për ta minuar sigurinë dhe stabilitetin.

## Zgjedhja e drejtorit të RTK-së, çështja shkon në interpretim ligjor

**PRISHTINË, 19 PRILL** - Kandidati për drejtor, Ngadhnjim Kastrati, mori votat e 6 anëtarëve të bordit nga 7 që ishin të pranishëm por, pavarësisht kësaj, është kërkuar interpretim ligjor për shkak të paqartësive në ligj. "Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), duke u bazuar në nenin 30, pika 7 të Ligjit për RTK-në, sot ka votuar në

mënyrë të hapur për kandidatët për drejtor të përgjithshëm. Kandidati i parë ka marrë 6 vota për dhe një kundër. Bazuar në nenin 30, pika 4, ku thotë se "kuorumi i mbledhjeve të Bordit është gjashtë (6) anëtarë", dhe meqenëse neni 32.3 i Ligjit për RTK-në është i paqartë rreth cilësimit të 2/3 të anëtarëve, Bordi ka vendosur që të kërkojë

interpretim ligjor për këtë nen. Pas marrjes së interpretimit ligjor, Bordi do ta konstatojë gjendjen", tha për "RTKLive", Afërdita Maliqi.

Në garë për drejtor të RTK-së ishin: Ngadhnjim Kastrati, Nexhmedin Spahiu, Menduh Abazi, Lorik Arifaj, Ragip Luta, Festim Kabashi dhe Azem Bujupi.



Gjashtë vjet nga marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi

# Kosova dhe Serbia, larg normalizimit të marrëdhënieve

Instituti Demokratik i Kosovës dhe njohësit e rrethanave politike kanë theksuar se Kosova dhe Serbia janë larg normalizimit të marrëdhënieve. Në gjashtëvjetorin e marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, KDI-ja ka vlerësuar se mungesa e zbatimit të plotë të kësaj marrëveshje nuk ka arritur t'i përmbushë pritshmëritë e qytetarëve. Ndërsa politologu Belul Beqaj ka deklaruar se procesi i dialogut në mes të dy vendeve për marrëveshjen përfundimtare është larg qëllimeve të paralajmëruara

**EPOKA E RE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 19 PRILL - Gjashtë vjet pas arritjes së marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, Instituti Demokratik i Kosovës dhe njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se Kosova dhe Serbia janë larg normalizimit të raporteve në mes tyre. Përmes një komunikate për medie, KDI-ja ka treguar se mungesa e zbatimit të plotë të kësaj marrëveshje nuk ka arritur t'i përmbushë pritshmëritë e qytetarëve. "Problematikat të cilat kanë shoqëruar zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve, por edhe shumicën e marrëveshjeve pasuese, janë: Ambiguiteti konstruktiv. Marrëveshjet përmbajnë dykuptimësi që krijojnë hapësirë për interpretimin të ndryshëm mbi aspekte të caktuara të obligimeve të parapara mes palëve. Në mungesë të një interpretimi objektiv të marrëveshjes nga ana e BE-së, palët kanë shfrytëzuar hapësirën e interpretimit të njëanshëm të marrëveshjes, duke zgjedhur mënyrën e (mos)zbatimit të saj", ka vlerësuar KDI-ja.

Sipas këtij instituti, fokusi i BE-së ka qenë i orientuar në lehtësimin e arritjes së marrëveshjeve mes palëve, por jo në garantimin e zbatimit të tyre. "Kjo është reflektuar edhe në Strategjinë për Zgjerim të Komisionit Evropian të vitit 2018, ku adresohet nevoja e arritjes së marrëveshjeve, pa u vënë theksi edhe te zbatimi i marrëveshjeve të arritura deri më tani. Si palë lehtësuese e dialogut, BE-ja nuk ka arritur t'i detyrojë palët që t'i zbatojnë marrëveshjet në afatet e përcaktuara kohore. Si pasojë e kësaj, zbatimi i marrëveshjeve ka mbetur në diskrecionin e Kosovës dhe Serbisë, që në mungesë të mekanizmave detyrues, kanë shtyrë zbatimin e marrëveshjeve apo dhe nuk i kanë zbatuar fare ato", ka treguar KDI-ja, duke shtuar se si rezultat i vonësive në zbatimin e tyre, pjesë të caktuara të marrëveshjeve edhe janë rinegociuar. "Mungesa e vullnetit politik. Si një proces i ndjeshëm politik, mungesa e vullnetit politik që shoqëroi procesin e dialogut mund të vlerësohet në dy nivele: në nivel të brendshëm dhe atë bilateral. Në nivelin e brendshëm, zhvillimet politike dhe shoqërore brenda dy shteteve ndikuan në

nivel të ulët të zbatimit të marrëveshjeve. Në nivelin bilateral në mes dy shteteve, implikimet politike të cilat derivojnë nga zbatimi i marrëveshjes, që ishin përtej aspektit teknik, ndikuan që palët, sidomos Serbia, të hezitojë t'i zbatojë marrëveshjet", ka vlerësuar KDI-ja.

Edhe politologu Belul Beqaj beson se procesi i dialogut në mes të dy vendeve për marrëveshjen përfundimtare është larg qëllimeve të paralajmëruara. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se mosuniteti i brendshëm dhe i jashtëm ka bërë që të zvarritet ky proces. "Vitet e fundit kanë qenë vazhdimisht vite historike për arritjen e marrëveshjes. Edhe qershori i këtij viti po trajtohet njëjtë. Por, realisht, dialogu është shumë larg qëllimit të pararenduar. Së pari, nuk ka unanimet brenda faktorit kosovar. Së dyti, situata në Serbi është komplikuar, ndonëse fuqia e kryetarit serb nuk është dëmtuar. Dhe, së fundi, nuk ka unanimet të plotë ndërkombëtar për qëllimin përfundimtar të dialogut mes Gjermanisë dhe ShBA-së. Takimi i prillit besoj se do ta orientojë zgjidhjen definitive brenda kufijve ekzistues", ka thënë Beqaj.



**Kërkohet konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut**

Duke marrë në konsideratë problemet e deritashme të këtij procesi, por edhe zhvillimet aktuale që ndërlidhen me fazën përmbyllëse të dialogut Kosovë - Serbi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka ofruar edhe disa rekomandime për procesin. Sipas këtij instituti, marrëveshja përfundimtare nuk duhet të shkruhet në frymë ambiguiteti, për duhet të arrihet një konsensus i gjerë politik, procesi duhet të jetë transparent, garantues i zbatimit të marrëveshjes duhet të jenë BE-ja dhe ShBA-ja, marrëveshja eventuale duhet të ketë afate strikte të zbatimit si dhe marrëveshja potenciale, përveçse duhet të ratifikohet nga parlamentet e të dy vendeve,

duhet të regjistrohet në Sekretariatit e OKB-së (UNTC) si marrëveshje ndërkombëtare, duke evituar interpretimet e ndryshme të palëve mbi natyrën e saj.

Marrëveshja e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe e nënshkruar nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Ivica Dačić, është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës më 27 qershor të vitit 2013 si marrëveshje ndërkombëtare. Kjo ka qenë e para dhe e vetmja marrëveshje e ratifikuar në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. E njëjta nuk është ratifikuar nga Kuvendi i Serbisë. Madje, Gjykata Kushtetuese e Serbisë e kishte cilësuar marrëveshjen e Brukselit si çështje politike dhe jo ligjore, andaj edhe kishte refuzuar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së saj.

## Tri subjekte politike kanë aplikuar për zgjedhjet në veri

Prishtinë, 19 prill (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK-ja), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lista Serbe, janë tri subjektet politike që kanë aplikuar për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit në katër komunat e veriut. Kështu ka bërë me dije Valmira Selmani nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në KQZ-së. "Të enjten ka qenë afati i fundit për aplikim për certifikim të subjekteve politike. Brenda këtij afati kanë aplikuar për t'u certifikuar tri parti politike për certifikim për komunat përkatëse", ka thënë Selmani.

Në mbledhjen e KQZ-së anëtarët e këtij institucioni kanë kërkuar të trajtohet komplet

aplikacioni i Listës Serbe dhe kandidatëve të saj, pasi tre prej tyre kanë dhënë dorëheqje pas vendosjes së taksës ndaj mallrave të Serbisë nga Qeveria e Kosovës dhe tash kanë aplikuar sërish

Anëtarë i KQZ-së nga Lëvizja Vetëvendosje, Adnan Rustemi, ka thënë se duhet të trajtohet më thellësisht komplet aplikacioni i Listës Serbe dhe kandidatëve të saj. "KQZ-ja e ka një rast të mirë në këto zgjedhje për t'i disiplinuar edhe kandidatët e Listës Serbe për sjelljet dhe veprimet e tyre të fundit në kursin e Republikës së Kosovës dhe të respektimit të legjislacionit dhe kushtetutshmërisë, por edhe të përgjegjësisë që kanë në raport me institucionet dhe legjislacionin", ka thënë Rustemi.



Shqetësime për kandidimin e anëtarëve të Listës Serbe ka shprehur edhe përfaqësuesi i LDK-së në KQZ, Florian Dushi. "Në këtë fazë zyrës t'i tërhiqet vërejtja që t'i shohë në detaje të

gjitha kushtet dhe kriteret që përcaktohen. Unë nuk flas për pjesën etike dhe politike, por për pjesën ligjore dhe kushtetuese të këtyre kriterëve, pra të shohë nëse i përmbushin të gjitha këto kriteret për t'i

dhënë mundësi pastaj KQZ-së që të diskutojë, nëse eventualisht mund të paraqesë pengesë, fakti i dorëheqjes së tyre dhe kandidimi i po të njëjtëve në zgjedhjet e ardhshme", ka thënë Dushi.

Flet për "Epokën e re", Zafir Berisha

# Koalicioni ka mundur të fu



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka vlerësuar se koalicioni qeverisës ka mundur të funksionojë edhe më mirë, por është ballafaquar me mungesë të numrave në Kuvend. Megjithatë, ai ka thënë se opozita nuk i ka numrat për ta rrëzuar qeverinë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se problemi është se nëse shkohet në zgjedhje në këtë kohë sa mund të përmirësohet situata. Prandaj, sipas tij, partitë duhet të diskutojnë për kohën se kur duhet të mbahen zgjedhjet. Berisha ka folur edhe për dialogun me Serbinë, për të cilin proces ka thënë se është në rrugë të gabuar. Për të pasur sukses ky proces, ai ka thënë se faktori politik duhet t'i unifikojnë qëndrimet, në të kundërtën këto bisedime bartin rreziqe serioze për Kosovën dhe rajonin

mund të vazhdohet kështu. Prandaj duhet të diskutohet midis partive politike për kohën se kur duhet të mbahen zgjedhjet", ka theksuar ai. Po në këtë intervistë Berisha ka folur edhe për dialogun me Serbinë, me ç'rast ka thënë se ky proces është në rrugë të gabuar. Sipas tij, për të pasur sukses, ai ka thënë se faktori politik duhet të bashkohet në qëndrime, në të kundërtën këto bisedime bartin rreziqe serioze për Kosovën dhe rajonin. "Bisedimet me Serbinë janë në rrugë të gabuar sepse gabimi trashanik i Kosovës ka qenë që në fillim kur në Bruksel është biseduar për vendin tonë dhe për problemet e brendshme me një shtet fqinjë i cili ka bërë gjenocid ndaj qytetarëve shqiptarë. Me një fjalë, Serbinë, të cilën e kemi larguar me luftë, politika e papërgjegjshme e ka kthyer përsëri si faktor me të cilin duhet të diskutohet", ka deklaruar Berisha. Ai ka shtuar se në Samitin e

Berlinit pret të sqarohen pozicionet rreth të ardhmes së Kosovës dhe Serbisë. "Në Samitin e Berlinit pres të sqarohet pozicionet edhe të organizatorit, por edhe të palëve Kosovë - Serbi rreth të ardhmes së tyre, por edhe të rajonit. Qëndrimet e përfaqësuesve të Kosovës në këtë samit janë tepër të rëndësishme, prandaj mendoj se nuk duhet të shkohet me dy qëndrime për një materie sepse dalim joseriozë dhe lëmë hapësirë për manovrim të logjikës politike ruso-sllave në rajonin e trazuar të Ballkanit", ka thënë Berisha.

**"Epoka e re":** Z. Berisha, të dielën në Maqedoninë e Veriut do të mbahen zgjedhjet presidenciale. Në këtë garë për herë të parë është një kandidat i pavarur shqiptar, Blerim Reka. Ju nëpërmjet një statusi në 'Facebook' keni kërkuar nga qytetarët ta mbështesin z. Reka. Si e shihni këtë proces dhe cilat janë prit-

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 PRILL - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Zafir Berisha, të premten u ka bërë thirrje qytetarëve të Maqedonisë së Veriut që ta votojnë për president kandidatin shqiptar Blerim Reka. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se zgjedhjet e së dielës, veçanërisht shqiptarët, do të tregojnë kulturë shtetfor-

muese. Ndërkohë, duke folur për zhvillimet politike në Kosovë, deputeti Berisha ka thënë se koalicioni qeverisës PAN ka mundur të funksionojë më mirë, por është ballafaquar me mungesë të numrave në Kuvend. Megjithatë, sipas tij, opozita nuk i ka numrat për ta rrëzuar qeverinë aktuale. "Mendoj se ka mundur të funksionojë edhe më mirë. Mazhoranca aktuale ka mungesë të numrave dhe është normale që gjërat nuk shkojnë

ashtu siç duhet. Rreziku i numrave ka qenë që nga dita e parë për këtë qeveri, mirëpo numrat mungojnë edhe për ta rrëzuar atë. Problemi nuk është veç te numrat, por tek ajo se, nëse shkojmë në zgjedhje në këtë kohë, çfarë mund të ndryshohet më mirë nga situata që jemi?", është shprehur Berisha, duke shtuar se partitë politike duhet të diskutojnë për kohën se kur duhet të mbahen zgjedhjet. "Në Kosovë gjithçka është e mundur, mirëpo nuk

# funksionojë edhe më mirë

**"Epoka e re":** Kjo qeveri dhe ky koalicion vazhdon t'i ketë problem numrat në Kuvend. Parashihni rrezik për rrëzimin e kësaj qeverie?

**Berisha:** Rreziku i numrave ka qenë që nga dita e parë për këtë qeveri, mirëpo numrat mungojnë edhe për ta rrëzuar atë. Problemi nuk është veç te numrat, por edhe tek ajo se nëse shkojmë në zgjedhje në këtë kohë, çka mund të ndryshohet për të mirë nga situata që jemi?

**"Epoka e re":** Është përfulur shumë në opinion çështja e zgjedhjeve të parakohshme. Do të ketë zgjedhje këtë vit?

**Berisha:** Në Kosovë gjithçka është e mundur, mirëpo nuk mund të vazhdohet kështu. Prandaj duhet të diskutohet midis partive politike për kohën se kur duhet të mbahen zgjedhjet.

**"Epoka e re":** Z. Berisha, qysh e shihni vazhdimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi me që ende nuk është pezulluar taksa? Çfarë pritjesh keni nga ky proces? Besoni se do të mund të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse këtë vit?

**Berisha:** Bisedimet me Serbinë janë në rrugë të gabuar, sepse gabimi trashanik i Kosovës ka qenë që në fillim kur në Bruksel është biseduar për vendin tonë dhe për problemet e brendshme me një shtet fqinj i cili ka bërë gjenocid ndaj qytetarëve shqiptarë. Me një fjalë, Serbinë, të cilën e kemi larguar me luftë, politika e papërgjegjshme e ka kthyer përsëri si faktor me të cilin duhet të diskutohet. Kosova në vitin 2008 e ka shpallur pavarësinë dhe nuk e di pse me Serbinë është dashur të flitet, ta zëmë, për urën në Mitrovicë dhe për shumë çështje të tjera që i takojnë Kosovës. Deklarata e Vuçiqit, se 'duhet të fitoj diçka nga bisedimet dhe duhet bërë kompromis me Kosovën', është një tregues për logjikën millosheviqiane të politikës zyrtare të Serbisë në raport me Kosovën. Por këtu mendoj se edhe Hashimi ka shkelur në 'dërrasa të kalbura', siç thotë populli, i cili me akrobacionet politike i ka dhënë mundësi Serbisë të bëhet faktor në tavolinë, që tash të qesë edhe kushte sikurse Kosova të jetë provincë e saj dhe jo shtet i pavarur. Për të pasur sukses në këtë përballje politike faktori politik dhe institucional fillimisht duhet t'i bashkojnë qëndrimet mes vete në përputhje me rendin kushtetues, pastaj të futen në përballje me Serbinë. Përndryshe, kështu si jemi aktualisht, bisedimet me Serbinë bartin rreziqe serioze për Kosovën dhe rajonin.

jet nga zgjedhjet e së dielës?

**Berisha:** Është proces normal siç është normal edhe kandidimi i z. Reka për president të Maqedonisë së Veriut. Në vendet demokratike, për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur, është e drejtë legjitime, edhe pse në rastin konkret dikush mund të jetë më i befashuar pse një shqiptar për herë të parë kandidon. Pres mbështetje masive nga qytetarët e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht nga shqiptarët për z. Reka, për të treguar kulturë shtetformuese dhe identitet kombëtar në vendin e vet ku janë autoktonë.

**"Epoka e re":** Si e komentoni qeverisjen e deritanishme të koalicionit PAN dhe rolin opozitar?

**Berisha:** Mendoj se ka mundur të funksionojë edhe më mirë. Mazhoranca aktuale ka mungesë të numrave dhe është normale që gjërat nuk shkojnë ashtu siç duhet.

## Presidenti Thaçi për Batalionin 'Atlantiku': Misionin për atdhe e kreu ballëhapur

**PRISHTINË, 19 PRILL (ER)** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë të premtën në akademinë e organizuar për 20-vjetorin e themelimit të Batalionit "Atlantiku". Thaçi ka thënë se Batalioni "Atlantiku" është sinteza më reprezentative e rrethit ciklik ose katër fazave të marrëdhënieve të shqiptaro-amerikanëve me atdheun dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Të parët tuaj, por edhe ju, shkuat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në atdheun e madh të lirisë dhe demokracisë. Shqiptarët e Amerikës kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm dhe historik për afirmimin e çështjes së Kosovës. Në çastet më të vështira për Kosovën ishte krejtësisht i natyreshëm reagimi juaj, sepse ju e dinit kuptimin e thellë të lirisë", u shpreh presidenti Thaçi.

Ai ka theksuar se Batalioni "Atlantiku" është treguesi më i qartë i historisë politike dhe ushtarake të shqiptarëve, prandaj pjesëtarët e tij u përgjigjen më së miri kushtimit "Atdheu në rrezik, vendlindja thërret". "Ju nga mirëqenia maksimale erdhët në luftë. Jeni betejë dhe fronti i luftës çlirimtare. Në kuadër të Batalionit 'Atlantiku',

ju luftuat drejtpërdrejt forcat pushtuese ushtarake serbe. Misionin tuaj ndaj atdheut e kryet ballëhapur", shtoi presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit theksoi se duke mposhtur forcat serbe së bashku me ndihmën e NATO-s, është realizuar misioni më i lartë kombëtar, patriotik dhe politik. "Ëndrrën e të gjithë gjeneratave e bëtë realitet. Ju hytë në Kosovë me ajrin e lirisë", ka theksuar ai.

Në mbyllje të fazës së katërt, pas kuptimësimit të lirisë, pjesëtarëve të Batalionit "Atlantiku", presidenti Thaçi u tha se pas luftës dhe sakrificës ju u kthyet sërish në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tek familjet tuaja, tek profesioni, puna dhe biznesi. "Si luftëtar ju veshët uniformat dhe morët armët në luftë për liri. Pas fitores, ju hoqët uniformën dhe ju kthyet jetës. Kështu bëjnë njerëzit e mëdhenj, ata që dinë se çka duan", ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka potencuar se sa më shumë që kalon koha, aq më shumë do të shtohet vlera e luftës çlirimtare. "Fëmijët tuaj dhe fëmijëve tuaj do të jenë krenarë me ju, sepse nuk lejuat që robëria e Kosovës të vazhdojë pa fund. Viti 2019 është shpallur vit i NATO-s në Kosovë", ka thënë ai.

I pari i vendit u shpreh mirënjohës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, NATO-s dhe shteteve të BE-së për atë që bënë për lirinë pavarësinë dhe ngritjen e Kosovës. Po ashtu, ai ka theksuar se përjetë do t'u jemi mirënjohës dhe do të përkulemi me respekt para vëllezërve Bytyçi, heronjve të Batalionit "Atlantiku" dhe gjithë heronjve të Kosovës.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në fjalën e tij para të pranishmëve, pjesëtarë të Batalionit "Atlantiku", përfaqësues institucionalë të nivelit qendror dhe lokal, shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, kryeministri Haradinaj ka thënë se për ato kohë të vështira të kombit tonë do të flitet gjithnjë brez pas brezi, "e kur flitet për ato kohë të vështira të kombit tonë në përgjithësi, kur flitet për luftën e Kosovës atëherë, fatmirësisht, në këtë historinë tonë të lavdishme edhe Batalioni 'Atlantiku' e ka pjesën e vet, e ka krenarinë e vet dhe është pjesë e historisë".

Në këtë akademi përkujtimore një fjalë rasti mbajti presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ndërsa në emër të Batalionit "Atlantiku" folën Mark Gjonaj dhe komandanti i Batalionit "Atlantiku", Gani Shehu.



## Pritet themelimi i qendrave të testimit elektronik për arsimin parauniversitar

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të premten në takim ambasadorin austriak në Prishtinë, Gernot Pfandler, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në mes të Qeverisë së Austrisë dhe Qeverisë së Kosovës për marrëveshjet të cilat tani më janë ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për pesë komuna të Kosovës që do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të këtyre komunave. Gjithashtu, ka biseduar edhe për mundësitë e bashkëpunimit për financimin e themelimit të qendrave të testimit elektronik për arsimin parauniversitar në Kosovë, ku shteti austriak ka shprehur gatishmërinë ta përkrahë Kosovën në këtë fushë. Me këtë rast, ministri Hamza ka theksuar përkushtimin e tij për mbështetjen e këtij sektori, me

qëllim të avancimit të arsimit para universitar në Kosovë ku, sipas tij, përfituesit më të mëdhenj do të jenë të rinjtë e Kosovës, të cilët janë potenciali më i madh në vend.

Ai ka thënë se Kosova është e gatshme të krijojë kushte për të arritur marrëveshje me partnerët strategjikë, siç është Austria, për avancimin e arsimit në Kosovë, si një ndër fushat më me prioritetet të Qeverisë. Ndërsa ambasadori austriak, Gernot Pfandler, e ka falënderuar ministrin Hamza për bashkëpunimin dhe ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të shtetit austriak për mbështetjen edhe në të ardhmen të institucioneve të Kosovës, veçanërisht për gjetjen e mundësive të përkrahjes së projekteve të tilla të cilat ndikojnë në avancimin e të rinjve si dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.



## Sali Çekaj, luftëtar i paepur për lirinë e Kosovës



PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë të premten në akademinë përkujtimore me rastin e Ditës së Veteranëve të Koshares dhe rënies së heroit të Kosovës, Sali Çekaj, në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e Shqipes 2019", që organizohet nën përkujdesjen e kryeministrit. Kryeministri Haradinaj gjatë fjalës së tij në këtë akademi përshtroi dimensionet e "Epopesë së Koshares", të heroit Sali Çekaj, duke thënë se rëndësia e fillimit të luftës, të "Epopesë së Koshares", ka qenë e madhe, historike, me dimensione të mëdha, duke hyrë në çastet më vendimtare në rrugën deri në liri. "Ju siguroj se një shembull i mirë ka për t'i bindur breza e breza pas neve e do të jetë vetë heroit i kombit, pra veterani Sali Çekaj. Të gjitha dimensionet e veprës së tij, përmasat e kësaj vepre, janë shembull i mirë për atdhetarë të ardhshëm. Janë shembull i mirë

duke pasur parasysh kohën në të cilën kemi vepruar. Një kohë më e vështira dhe më e paqarta e mundur. Kohë e vlimeve politike, por edhe e vlimeve ushtarake", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se të rënë për liri janë vlera e vetme sublime e jona. Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka përkujtuar 20-vjetorin e rënies së Sali Çekaj. Ai ka thënë se Sali Çekaj ishte atdhetar i pashoq dhe luftëtar i paepur për lirinë e Kosovës. "Vepra kolosale e Sali Çekaj u bë burim frymëzimi për bashkëluftëtarët e tij. Ndonëse po bëhen 20 vjet nga rënia e gjeneral Çekaj, kujtimi për të do të mbetet përgjithmonë", ka thënë Limaj. Në këtë akademi nga një fjalë rasti mbajtën edhe Agron Isufi në emër të "Brigadës 138 Agim Ramadani" dhe në emër të familjarëve të dëshmorëve dhe të familjes së heroit të Kosovës, Sali Çekaj, djali i heroit, Hysen Çekaj.

## Fillojnë stërvitjet shkollore për "zvogëlimin e rreziqeve nga tërmetet"

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Agjencia e Menaxhimit Emergjent e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucioni përgjegjës i emergjencave i Republikës së Turisë AFAD, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë filluar zbatimin e projektit: "Zvogëlimi i rreziqeve nga tërmetet". Ky projekt ka për qëllim mbajtjen e stërvitjeve shkollore me simulator për tërmete. Trajnimi do të zgjasë pesë

javë, ndërsa gjatë tërë kësaj kohe automjeti me simulator nga Turqia do të qëndrojë në Kosovë. Qëllimi i kësaj stërvitjeje shkollore është sensibilizimi, njohja dhe përgatitja e nxënësve se si duhet të sillen dhe të mbrohen në rastet e tërmeteve.

Në kuadër të këtij ushtrimi janë paraparë të përshihen rajoni i Gjilanit në pesë komuna, rajoni i Prishtinës në pesë komuna, rajoni i Mitrovicës në pesë komuna,

Rajoni i Pejës në pesë komuna dhe rajoni i Prizrenit në pesë komuna. Agjencia për Menaxhim të Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në kuadër të prioritetëve të veta strategjike, vazhdimisht harton plane të ushtrimeve operative, me qëllim të parandalimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera për përgatitjen e qytetarëve në rast se vendi ynë mund të ballafaqohet me ndonjë fatkeqësi.



# Nis puna për draftimin e ligjit që ndëshkon mohimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 PRILL - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të premten në takim ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, me të cilin ka diskutuar në lidhje me përgatitjen e bazës ligjore për ligjin për ndëshkimin e mohimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Hoxhaj ka thënë se mohimi i krimeve të kryera gjatë luftës është krim i dyfishtë ndaj viktimeve, ofendim ndaj familjeve dhe ndaj shtetit, prandaj në të ardhmen një gjë e tillë nuk do të lejohet. "Lufta e vitit '98-'99 ka sjellë dëme të pariparueshme në Kosovë, në mesin e të cilave shumë viktima civile, për të cilat shteti i Kosovës do të vazhdojë ta kërkojë identifikimin dhe dënimin e përgjegjësve", ka thënë Hoxhaj. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka folur edhe për iniciativën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili sot do t'u dërgo-

jë letra homologëve të tij, duke kërkuar që parlamentet në botë të nxjerrin rezoluta zyrtare përmes të cilave e dënojnë rolin e shtetit serb si shkakhtar i krimeve të llahtarshme kundër njerëzimit në Kosovë. "Një rezolutë e tillë jo vetëm që ndërgjegjëson shoqërinë që krimet çnjerëzore si ato të luftës në Kosovë të mos përsëriten më, por i kontribuojnë edhe pajtimit ndëretnik i cili është i pamundur nëse nuk thuhet e vërteta", ka përfunduar zëvendëskryeministri Hoxhaj. Ndërsa ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka folur për punën që po bën Ministria e Drejtësisë në drejtim të përgatitjes sa më të shpejtë të bazës ligjore. Ai ka thënë se ky ligj do ta dënojë mohimin e çdo krimi ndaj çdo viktime civile pa dallim. "Është një iniciativë shumë e nevojshme e cila do të sigurojë që çdokush që mohon krime të kryera gjatë luftës në Kosovë do të dënohet. Jemi duke i parë modalitetet e krijimit të bazës ligjore dhe jemi në konsulta në këtë drejtim", ka thënë Tahiri.



## Malisheva, Suhareka, Rahoveci dhe Klina, komunat më të prekura nga pickimi i rriqrave

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 PRILL - Nën udhëheqjen e ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, është mbajtur takimi i radhës i këshillit ndërministror për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo. Në hapjen e këtij takimi, ministri Ismaili ka thënë se takimi i Këshillit mbahet me qëllim të përgatitjeve sa më të mira për ballafaqim me ethet hemorragjike, për ta zvogëluar sa më shumë sëmundshmërinë nga ethet hemorragjike që shkaktohen si pasojë e pickimit dhe infektimit nga rriqrat. "Ne po bëjmë të gjitha parapërgatitjet që të jemi të gatshëm të reagojmë,

sidomos në zonat endemike që njihen si më të ekspozuara nga kjo sëmundje: Zona e Malishevës, e Suharekës, e Rahovecit, e Klinës, por edhe kudo tjetër që paraqitet nevoja", ka thënë ministri Ismaili. Ministri Ismaili ka shtuar se "si trup operativ duhet të përgatitemi që të mos lejojmë që virusi ARN, i cili shkakton ethet hemorragjike krime kongo, të jetë vdekjeprurës ashtu si në vitin 2013, kur kishim njëmbëdhjetë viktima apo vite të tjera para këtij viti, por të vazhdojmë me rezultate të viteve pas 2013-s, ku kemi zero vdekje dhe rënie të numrit të qytetarëve që preken nga rriqrat. Drejtori i IKSHP-së, Naser

Ramadani, ka thënë se në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera do të zbatohen aktivitetet e planit operacional me qëllim të parandalimit dhe luftimit të EHCC-së. Isuf Cikaqi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka treguar se tashmë mbi 4 000 hektarë janë dezinesktuar, ndërkohë së bashku me Komunën e Malishevës do t'i përcaktojnë edhe zonat e tjera që të vazhdohet dezinfektimi. Në katër komunat që zakonisht janë më të prekura nga pickimi i rriqrave, Malishevë, Suharekë, Rahovec dhe Klinë, më 25 prill do të vazhdojë edhe procesi i repelimit të kafshëve, që do të ndikojë në zvogëlimin e rasteve të prekura.

## Ministri Bytyqi dhe rektorët e universiteteve dhe kolegjeve diskutuan rreth qasjes në 'Erasmus+'

Prishtinë, 19 prill (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka takuar të premten rektorët e universiteteve publike dhe kolegjeve private, me të cilët ka diskutuar rreth qasjes në programin 'Erasmus+', në mënyrë që institucionet tona të arsimi të lartë të mund të përfitojnë sa më shumë nga ky program. Ministri Bytyqi ka ritheksuar se programi 'Erasmus +' është

shumë i rëndësishëm sa i përket mobilitetit të studentëve, profesorëve dhe ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, ndërsa ka shtuar se qëllimi i takimit është koordinimi i veprimeve, në mënyrë që të sjellim sa më shumë fonde në Kosovë. "MASHT-i është e gatshme që në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të hartojë politika që do të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit akademik brenda institucioneve

tona", ka thënë ministri Bytyqi. Në fund të takimit, ministri Bytyqi dhe përfaqësuesit e universiteteve u pajtuan që të formohet një grup punues me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve të arsimit të lartë, i cili do të merret me trajtimin e problemeve për implementimin e projekteve aktuale, si dhe me hartimin e një plani të veprimit, në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë fonde nga programi 'Erasmus+'.



# Vala TV për shtatë ditë arrin 150 mijë shkarkime

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se për shtatë ditë Vala TV ka arritur 150 mijë shkarkime. "Jam i entuziazmuar me interesimin e madh të konsumatorëve tanë për ta shkarkuar dhe përdorur platformën tonë më të re televizive Vala TV. Vetëm brenda një jave, nga dita e lansimit zyrtar, Telekom i Kosovës ka shënuar shifër rekorde të shkarkimit të këtij aplikacioni, më saktësisht bëhet fjalë për mbi 150 mijë shkarkime, ndërsa përdorues aktivë në këtë moment janë afër 90 mijë", ka thënë Istrefi të premtën.

Ai ka treguar se është informuar edhe nga drejtori teknik që ky aplikacion është duke u pëlqyer së tepërmi nga konsumatorët, meqë ofron lehtësira teknike të përdorimit, duke u mundësuar konsumatorëve t'i personalizojnë në kohë reale kanalet dhe programet e tyre të preferuara. "Vala TV (OTT) është platforma televizive më e re dhe më e

mirë për konsumatorët, pasi përmban cilësi shumë të lartë audio dhe video të transmetimit (streaming) dhe ofrohet përmes lidhjes së internetit me shpejtësi të lartë. Kjo platformë televizive iu mundëson konsumatorëve tanë t'i shohin kanalet televizive kudo që ata ndodhen, gjatë gjithë kohës, në tableta, telefona të mençur etj", ka thënë ai.

Istrefi ka theksuar se Vala TV ofron qasje të lehtë për konsumatorët, përmes aplikacionit të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, i cili tashmë mund të gjendet në "App Store" dhe "Play Store". "Në platformën Vala TV bëjnë pjesë kanalet televizive më të shikuara të vendit, por edhe ato 'Pay TV', duke iu mundësuar konsumatorëve të kenë zgjedhje të shumta të këtij shërbimi. Vala TV, përveç televizionit tradicional, gjithashtu ofron edhe shërbime të tjera si video on demand (video me kërkesë), një arkiv apo bibliotekë, e cila është kategorizuar sipas llojit të përmbajtjes dhe plotëson më



së miri kërkesat e konsumatorëve të grupmoshave të ndryshme, me kategori të shumëllojshme filmash, serialesh, dokumentarësh, muzikë, një seksion të veçantë për

miqtë tanë më të vegjël, si edhe personalizim e kontrollë të tjera të përmbajtjes", është shprehur Istrefi. Ai ka shtuar se Telekom i Kosovës synon që të bëhet ofruesi më i preferuar i

platformave televizive përmes rrjeteve digjitale, duke sjellë inovacionin e televizionit të gjeneratës së re, për t'i përmbyshur pritjet e përdoruesve të kësaj platforme.

## Veseli: Do t'i rrisim subvencionet për të gjithë fermerët e Kosovës



ISTOG, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar fermerët e fshatit Kovragë të Istogut, të cilët kultivojnë mbi 200 hektarë të mbjel-la me mollë.

Kryeparlamentari Veseli, gjatë bashkëbisedimit me dhjetëra fermerë të Kovragës, i ka siguruar ata se do të vazhdojë rritja e subvencioneve për të dhe gjithë fermerët e Kosovës. "Subvencionet në bujqësi nuk do të ndalen, por do të rriten edhe më shumë, sepse njerëzit që më së shumti kanë nevojë dhe e meritojnë të ndihmohen, janë ata që punojnë dhe fitojnë me djersën e tyre. Ne do ta vazhdojmë përkrahjen, që tani të kalojmë te pjesa e ngritjes së kapaciteteve përpunuese të pemëve, në mënyrë që të rritet vlera e produkteve. Po ashtu, tani shpejt fillon sigurimi i plantazheve, për çka Ministria e Bujqësisë do të participojë me

gjysmën e shpenzimeve", ka thënë Veseli.

Kreu i Kuvendit inkurajoi kultivuesit e mollës në Kovragë që të bëhen bashkë dhe të kalojnë nga kultivimi në përpunim të pemëve, duke i siguruar se do t'i mbështesë për hapjen e një fabrike e cila do të krijonte edhe shumë vende të reja të punës. "Këtë vit janë dhënë 30 milionë euro mbështetje për bujqësi, ndërsa në vitin tjetër do ta rrisim mbështetjen në 50 milionë euro, sepse fermerët tanë duhet të mbështeten edhe më shumë", është shprehur kryeparlamentari Veseli.

Nazmi Blakaj, kultivues i rreth 20 hektarëve mollë në Kovragë të Istogut, e falënderoi kryeparlamentarin Veseli për kujdesin dhe ndihmën e vazhdueshme për të gjithë fermerët. Fshati Kovragë i Istogut kultivon pemë në një sipërfaqe mbi 200 hektarësh.

## Reçica fton punëtorët dhe punëdhënësit t'i respektojnë masat e sigurisë dhe shëndetit në punë

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica ka vizituar të premtën një nga vendpunishtet e ndërtimit të lartë në Prishtinë, për ta parë nga afër respektimin e masave të sigurisë dhe shëndetit, si parakushte për parandalimin e lëndimeve dhe vdekjeve në vendin e punës.

Ministri Reçica me këtë rast ka takuar punëdhënësit dhe punëtorët me të cilët ka biseduar rreth rëndësisë së respektimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, përkatësisht të legjislacionit nga kjo fushë. Reçica ka theksuar se punëtorët në Kosovë meritojnë kushte dinjitoze për punë, në përputhje me standardet

evropiane dhe, mbi të gjitha, siguri dhe shëndet në vendin e punës. "Jeta e punëtorëve tanë vlen dhe ne duhet ta mbrojmë atë. Do të jemi të pakompromis për zbatimin e legjislacionit aktual nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, por edhe këmbëngulës në përpjekjet për avancimin e mëtejshëm të tij", ka thënë Reçica.





# Haradinaj: Me luftimin e ekonomisë joformale ndihmohet zhvillimi ekonomik



Në kuadër të vitit të ekonomisë, i shpallur nga kryeministri Ramush Haradinaj, të premtën në Qeverinë e Kosovës është mbajtur takimi në mes të aktorëve ekonomikë dhe të sigurisë, ku u theksua se luftimi i ekonomisë informale do t'i hapë rrugë zhvillimit ekonomik

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 PRILL - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premtën një takim me ministrin e Financave, Bedri Hamza, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, drejtorin e Policisë, Rashit Qalaj, drejtorë të agjencive të

ndryshme, përfaqësues të USAID-it, si dhe organizata të tjera që kontribuojnë me projekte në fushën e ekonomisë, me të cilët ka biseduar për ekonominë joformale në Kosovë dhe për mënyrën e luftimit të kësaj dukurie e cila ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit dhe dëmton konkurrueshmërinë dhe tregun e lirë në vend. Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka kërkuar nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse për

ndërmarrjen e hapave për zbatimin e ligjit nga institucionet e rendit dhe të ligjit dhe për avancimin në këtë fushë, duke potencuar se një nga burimet e krimin dhe të korrupsionit është edhe ekonomia joformale. "Me luftimin e ekonomisë joformale do të ndihmohet zhvillimi ekonomik, rritja e buxhetit dhe shumë parametra në ekonominë e vendit", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se lufta kundër ekonomisë joformale

mund të arrihet vetëm me koordinimin e të gjithë institucioneve përgjegjëse.

Ndërkaq ministri i Financave, Bedri Hamza, ka deklaruar se Qeveria e Kosovës ka kontribuar dukshëm në rritjen ekonomike të vendit, duke thënë se tani po punohet që sektori privat të ketë kushte më të mira të të bërit biznes. Në këtë takim, së bashku me aktorët përgjegjës në luftën kundër ekonomisë joformale, të pranishmit u pajtuan që Kosovës i duhet një mobilizim i shtuar në këtë sferë ngaqë evazioni fiskal gërryen shtetin dhe demotivon bizneset e rregullta, duke goditur kështu edhe funksionimin e ligjit.

Në kuadër të kësaj përpjekjeje për luftimin e ekonomisë joformale, Qeveria e Kosovës ka

ndërmarrë një varg aktivitete të cilat adresojnë këtë dukuri dhe këto përfshijnë: Rishikimin e strategjisë për luftimin e ekonomisë joformale, hartimin e konceptdokumentit për largimin e barrës administrative, duke përfshirë uljen e numrit të lejeve dhe licenca për bizneset, hartimin dhe miratimin e ligjit për inspektime që synon uljen e numrit të trupave inspektuese, duke mundësuar kështu efikasitet më të lartë të inspektiveve. Krahas këtyre masave, kryeministri Haradinaj ka filluar një nismë për t'i identifikuar intervenimet specifike për luftimin e ekonomisë joformale me qëllim të zvogëlimit të konsiderueshëm të ekonomisë joformale deri në fund të vitit 2019.

## Ministrja Ziviq merr mbështetjen e UNKT-së për zhvillimin e bujqësisë

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministrja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Dijana Ziviq, ka pritur të premtën në takim koordinatoren e zhvillimit për Kombet e Bashkuara në Kosovë, Ulrika Richardson, dhe Vlora Nushi, shefe e Zyrës së "UN Women" në Kosovë. Gjatë këtij takimi është biseduar për bashkëpunimin e deritanishëm

mes dy institucioneve si dhe për projektet e shumta në ngritjen e kapaciteteve të ministrisë të cilat pritet të realizohen në të ardhmen.

Ministrja Ziviq ka vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm në mes të MBPZHR-së dhe UNKT-së dhe ka shprehur vullnetin për ta thelluar edhe më tej bashkëpunimin me mes tyre, me

qëllim të zhvillimit dhe avancimit të mëtejshëm të sektorit të bujqësisë në Kosovë. Në anën tjetër, koordinatorenja e zhvillimit për Kombet e Bashkuara në Kosovë, Ulrika Richardson, ka vlerësuar punën që po bëhet për avancimin e sektorit të bujqësisë dhe ka shtuar se si institucion do ta vazhdojnë përkrahjen e këtij sektori përmes projekteve të ndryshme.



## Idriz Vehapi zyrtarizon kandidaturën për kryetar të Degës së PDK-së në Rahovec

RAHOVEC, 19 PRILL (ER) - Idriz Vehapi ka zyrtarizuar të premtën kandidaturën për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Rahovec. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gjatë

zgjedhjeve të brendshme kanë dhënë shembullin më të mirë të demokracisë. "Të dielën do t'i përfundojmë këto zgjedhje në degën tonë dhe unë pres përkrahjen tuaj, me zotimin se do të punoj gjithmonë bashkë me juve ndershëm,

siç kam punuar gjatë gjithë jetës. Dekada e Re po na pret për ta dhënë fuqishëm kontributin për jetësimin e saj, sepse kjo është shpresa për jetë më të mirë në Rahovecin tonë, në Kosovën tonë", ka thënë Vehapi.



## Fondacioni 'Solon' dhuron 140 kompjuterë për dy shkollat e mesme të Skenderajt



Skenderaj, 19 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku dhe drejtori i Arsimit, Bekim Latifi, kanë vizituar dy shkollat e mesme të qytetit, Gjimnazin "Hamëz Jashari" dhe Shkollën e Mesme Teknike "Anton Çetta", të cilat kanë përfituar një donacion nga Fondacioni zviceran "Solon" prej 140 kompjuterëve, për punën praktike në kabinetet e tyre të teknologjisë. Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit e

shkollave të mesme, kryetari Jashari u ka thënë atyre të jenë të angazhuar maksimalisht në procesin edukativo-arsimor, tanimë që kushtet për mësim praktik, janë më të mira. Kryetari Jashari ka premtuar përkrahje të vazhdueshme për nxënësit e komunës sonë, me anë të ndarjes së bursave, për nxënës të dalluar. Të shtunën e kaluar kryetari Jashari ka nënshkruar marrëveshjet me studentët e Skenderajt për ndarje të 164 bursave në vlerë prej 500 eurove për secilin student.

## Komunitetet në Vushtrri trajnohen për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë

VUSHTRRI, 19 PRILL (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në bashkëpunim me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe partneri implementues, Kryqi i Kuq i Kosovës, organizuan të premtën një ushtrim fushor për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në fshatin Maxhunaj në Komunën e Vushtrrisë. Ushtrimi ishte pjesë e planit komunal të punës për t'i testuar kapacitetet operacionale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera dhe për t'i trajnuar

më tej pjesëmarrësit për parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive në një mënyrë që u shërben nevojave të gjinive të ndryshme, si dhe ndërtimin e besimit brenda komunitetit ku po zhvillohet stërvitja.

Në ushtrim morën pjesë edhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës, zjarrfikësve, Qendrës së Mjekësisë Familjare, përfaqësuesve të Organizatave së Shoqërisë Civile, institucioneve arsimore, komuniteteve lokale dhe të gjitha institucioneve të tjera përkatëse të Komunës së Vushtrrisë.

Rreth 200 pjesëmarrës ishin të përfshirë drejtpërdrejt në këtë ushtrim dhe më shumë se 1 800 sosh në aktivitetet përgatitore, ku rreth 60 për qind prej tyre ishin meshkuj dhe 40 për qind femra. Ushtrimi u zhvillua në kuadër të projektit "Ndërtimi i besimit përmes reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes gjinore", i financuar nga Qeveria e Japonisë, qëllimi i të cilit është përsheptimi i procesit të ndërtimit të kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse lokale dhe qendrore përgjegjëse për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.



## Nënshkruhet marrëveshja për rregullimin e shtratit të përroit në Rubovc të Kamenicës

KAMENICË, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancimin e projektit "Rregullimi i shtratit të përroit në Rubovc - Kamenicë". "Ky

projekt, i cili ka vlerën prej 100 000.00 euro do të ndikojë në radhë të parë në mirëqenien e nxënësve që e shfrytëzojnë atë pjesë dhe gjithë komunitetin", ka thënë Kastrati, i cili ka falënderuar ministrin Matoshi dhe kabinetin e tij për angazhimin e tyre për ta ndihmuar Komunën e Kamenicës.



## Asamblejtja e PDK-së në Mitrovicë i bashkohet AKR-së

MITROVICË, 19 PRILL (ER) - Shkurta Shosholli Musa, asambleiste nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, është bërë pjesë e

grupit të asambleistëve të AKR-së. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri. "Sikurse zonja Shkurta, ashtu edhe të gjithë njerëzit e vullnetit

të mirë, të cilët e duan të mirën e qytetit të tyre, janë të mirëseardhur t'i bashkëngjiten vizionit, vullnetit dhe preokupimit tonë për një Mitrovicë më të mirë. Ashtu siç

është e ditur, znj. Shkurta Shosholli Musa ka qenë asambleiste nga radhët e PDK-së, kurse nga sot e tutje ajo është pjesë e familjes së grupit të asambleistëve të AKR-së", ka thënë Bahtiri.



# Votojeni Blerim Rekën, mos i dëgjoni politikanët e korrumpuar; njerëzisht, kombëtarisht, moralisht, politikisht dhe materialisht!



**Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA**

Zgjedhjet në një shtet ku shqiptarët nuk janë popull: Pas marrëveshjes midis Tziprasit dhe Zaevitit për emërtimin e Maqedonisë së Veriut ku shqiptarët patën një rol përcaktues e që nuk fituan asgjë përveçse e përjashtuan veten përfundimisht nga të qenit popull shtetformues, në këtë shtet po mbahen zgjedhjet presidenciale ku, si kandidat i pavarur, po garon një personalitet i respektuar akademik dhe njerëzor, z. Blerim Reka, një ndër njohësit më të profesionalizuar dhe dëshmuar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përveç një bagazhi të pasur akademik dhe shkencor, Blerim Reka ishte edhe ambasador i Maqedonisë së Veriut në Bruksel dhe, mbi të gjitha, z. Reka është i pastër në aspektin e korrupsionit akademik dhe material. Kandidati shqiptar i hyri garës për president të Maqedonisë së Veriut, si kandidat i pavarur, duke siguruar nënshkrimet e

nevojshme. Midis dy kandidatëve maqedonas, njëri të Gruevskit dhe Ivanovit, kurse tjetrit të Zaevit dhe Ahmetit, Blerim Reka nuk ka gjasa të fitojë në këto zgjedhje dhe do të llogaritet sukses, nëse hyn në raundin e dytë të votimeve aq më parë që do të ketë refuzim konsensual të votuesve maqedonas sikur që edhe partitë shqiptare, kometa (bishta) të Zaevit dhe mbeturinat e Gruevskit që flasin shqip, do të votojnë, ose për kandidaten e Gruevskit apo për kandidatin, siç thuhet konsensual, PENdarovskin të politikanëve të korrumpuar shqiptarë, shoqëruar të Zaevit. Mendoj se votuesit shqiptarë në Maqedoninë e Veriut nuk duhet të futen fare si pykë midis DPMNE - VMRO dhe LSDM por se, pa asnjë dyshim duhet të votojnë për Blerim Rekën, kandidatin shqiptar i cili në çdo aspekt është më i kualifikuar se dy kandidatët e tjerë që, sipas deklarimeve të disa "liderëve" shqiptarë që moti iu ka skaduar mandati edhe i keqpërdorimit, duhet të përkrahen si çmim për integritet në NATO dhe BE, slogan ky mashtrues që skajshmërisht është keqpërdorur në Kosovë, që nga përfundimi i luftës e deri më tani. Në një shtet ku nuk ka supremacion të një populli mbi tjetrin, çështja se kujt ia jep

votën nuk ndërlidhet aspak me përkatësi kombëtare, por ekskluzivisht është votë drejt një adrese që mendoni apo edhe keni një siguri se mund t'i realizoni pritjet tuaja. Në një vend ku një nacionalizëm i skajshëm (ai i Gruevskit) zëvendësohet me një nacionalizëm "demokratik" që për interesa të ndryshme pranohet nga ndërkombëtarët si një "qasje pragmatike dhe frymë e re" (ky i Zaevit), votuesit shqiptarë as që do të duhej të mendonin se për kënd duhet të votojnë; duhet të votojnë për Blerim Rekën, pa asnjë dyshim! Pas inaugurimit dhe promovimit si një pater familie "demokratik" maqedonas, Zaevi, me ndihmën e një shtrese kuisinge shqiptare, krijoi një pasqyrë mashtruese ku shqiptarët mbetën aty ku ishin edhe në kohën e Gruevskit, duke mos lëvizur as edhe një milimetër të vetëm drejt të fituarit të statusit të popullit shtetformues apo konstitutiv. Mbetën në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut si një grusht minoritarësh por se, më me shumë se 35 për qind të përbërjes së popullsisë së gjithëmbarshe në këtë shtet, përbëjnë një trup të fuqishëm votues, vota e të cilëve është përcaktues për ardhje dhe mbajtje të pushtetit, të maqedonasve, gjithsesi! Nuk është ndonjë fitore të qenit spiker apo

folës, si kryetar i Kuvendit, ku jeni të privuar nga të gjitha kompetencat ekzekutive që përcaktojnë përmbajtjen dhe dinamikën e zhvillimit politik, ekonomik, kulturor të kombit që i takoni siç ndodhi pas shkuarjes në pushim, me ndihmën e pushtetit gjithsesi të Nik Gruevskit në Hungari, me ç'rast gjeti strehim bujar te një nacional - shovinist, apo njëri ndër mohikanët e fundit të këtij lloji, Viktor Urban. Sot në Maqedoninë e Veriut nuk mund të gjeni as edhe një votues të vetëm maqedonas që do të votonte për Blerim Rekën, ndërkohë që disa "udhëheqës të popullit shqiptar kërkojnë që me konsensus të votohet kandidati maqedonas, i Zaevit apo Gruevskit, nuk ka fare rëndësi. Emancipimi politik dhe kultura votuese nuk ka arritur ende atë nivel në Maqedoni të Veriut sikur edhe në asnjë vend të Ballkanit që të votohet për programin e kandidatit garues, prandaj as votuesit shqiptarë, së paku në këtë kohë, nuk duhet t'i nënshtrohen këtij stereotipi apo statusi të votuesit internacionalist. "Udhëheqësit e Popullit Shqiptar 'në Maqedoninë e Veriut e kanë një arsye të fortë të shiten si internacionalistë, evropianë dhe globalisht për faktin se duan që ta shpëtojnë lëkurën

dhe kokën, duan të amnistohen e nuk do të amnistohen kurrë nga përgjimet e Gruevskit dhe Mialkovskit e që i ka trashëguar Zaevi, duan t'i mbrojnë milionat e vjedhur, duan t'i ikin përgjegjësisë për çdo gjë shqiptare të shkatërruar në këtë shtet ku shqiptarët janë qytetarë të rendit të dytë, prandaj nuk e përkrahin kandidatin Blerim Reka, prandaj e kërkojnë nga ju votën kundër kandidatit shqiptar! Për këtë arsye, në shenjë të refuzimit të kërkesës së kësaj klase të korrumpuar për t'i votuar kandidatët e Gruevskit dhe Zaevit, votoni për Blerim Rekën i cili nuk ka gjasa të fitojë, por ua jep mundësinë të mos keni probleme me ndërgjegjen tuaj në të ardhmen. Shqiptarët e këtij shteti e pyetën mundësinë të imponohen si popull shtetformues dhe faktor politik në Maqedoninë e Veriut por, falë votuesve të Gruevskit dhe Zaevit të identifikuar në figurat e "Udhëheqësve të Popullit Shqiptar", mbetën në margjina dhe të defaktorizuar. Për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera, mos i dëgjoni dhe votoni për kandidatin shqiptar! Mos u bëni pjesë e mashtrimit votues sepse këta nuk e marrin përgjegjësinë dhe adresimin e përgjegjësisë jua sjellin para dyerve. Votojeni në mënyrë të qytetëruar dhe paqësore!

## 'Isa Boletini' anëtarësohet në Asociacionin e Universiteteve Ballkanike

MITROVICË, 19 PRILL (ER) - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) është bërë anëtar i rregullt i Asociacionit të Universiteteve Ballkanike (BUA) me të drejtë vote. Në konferencën që u mbajt në Selanik të Greqisë, për anëtarësimin e UMIB-it, kanë votuar në mënyrë unanime të gjithë anëtarët e BUA-së. Dekani i Fakultetit Ekonomik, Besart Hajrizi, i cili përfaqësoi UMIB-in në këtë konferencë, ka thënë se anëtarësimi në këtë asociacion lehtëson ndërkombëtarizimin e UMIB-it si dhe mundëson bashkëpunimin në fusha të ndryshme. "Të qenit anëtar në BUA lehtëson mobilitetin e stafit akademik dhe stu-

dentëve, mundëson organizimin e konferencës vjetore të BUA-së dhe, përgjithësisht, mundëson shkëmbimin e përvojave të universiteteve ballkanike", është theksuar në njoftimin për media të Universitetit të Mitrovicës 'Isa Boletini'. Ndër aktivitetet përgjatë tri ditëve të konferencës ishte edhe prezantimi i UMIB-it nga ana e dekanit Hajrizi. Ai ka folur për zhvillimin dhe konsolidimin e universitetit për një periudhë të shkurtër kohore. Gjatë takimeve përfaqësues të universiteteve të ndryshme ballkanike shprehën interesim për realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me UMIB.



## Kryetarët e komunave të Prizrenit dhe të Suharekës, aksion të përbashkët të pastrimit

PRIZREN, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, të premten, së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ndërmorën një aksion simbolik të pastrimit të zonës kufitare në mes të komunës së Prizrenit dhe asaj të Suharekës. Në një fjalë rasti kryetari Haskuka ka thënë se komunat tona nuk mund të qëndrojnë në nivelin e kënaqshëm të pastërtisë, nëse të gjithë nuk vetëdijesohemi për moshedhjen e mbeturinave nëpër hapësira

publike dhe nëse materiet inerte nuk i dërgojmë në vendet përkatëse. Më tej, kryetari Haskuka u bëri thirrje të gjithë qytetarëve që t'u bashkëngjiten këtij aksioni për pastrimin dhe ruajtjen e ambientit. Kurse kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se qëllimi kryesor i këtij aksioni është vetëdijësimi i qytetarëve, duke theksuar se përkushtimi për një ambient më të pastër dhe më të gjelbër do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Erdogan: Turqia qëndron në këmbë dhe do të rritet më fuqishëm

ANKARA, 19 PRILL - Rezultatet jo të favorshme në zgjedhjet lokale, duket se kanë shqetësuar disi liderin turk Rexhep Tajip Erdogan. Presidenti Erdogan deklaroi se partia e tij në pushtet do të vazhdojë të kundërshtojë parregullsitë në zgjedhjet lokale deri në fund, duke shtuar se organi më i lartë i zgjedhjeve në vend do të ketë fjalën e fundit për këtë çështje. "Kur Këshilli Suprem i Zgjedhjeve të marrë vendimin përfundimtar, çështja mbi zgjedhjet do të përfundojë për ne", tha presidenti Erdogan në Ankara.

Miliona votues turq votuan në mbarë vendin më 31 mars, në zgjedhjet lokale për të zgjedhur krerët e bashkive, anëtarët e këshillit të qytetit dhe zyrtarë të tjerë për pesë vjetet e ardhshme. Duke kundërshtuar rezultatet, partia qeverisëse për Drejtësi dhe Zhvillim (AK Parti) kërkoi një rinumërim, duke thënë se kjo mund të ndryshojë rezultatet. Duke kritikuar disa nga mediet

perëndimore që përpiqen ta paraqesin ekonominë në dritë negative, presidenti Erdogan tha: "Çfarëdo që të bëni, cilët do tituj që përdorni, Turqia qëndron në këmbë dhe do të vazhdojë rrugën e saj duke u rritur më fuqishëm". Erdogani kritikoi gazetën britanike "Financial Times" për mbulimin e saj të Turqisë, duke kërkuar vëmendje ndaj qëndrimit të Londrës për refugjatët.



# Demokratët vazhdojnë presionin mbi Trumpin rreth raportit për Rusinë

Demokratët në Shtetet e Bashkuara duan që Robert Mueller, këshilltari i posaçëm që ka hartuar raportin, të dëshmojë publikisht përpara Kongresit për punën që ka bërë duke vazhduar kështu presionin mbi presidentin Donald Trump, edhe pas publikimit të raportit për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e vitit 2016

WASHINGTON, 19 PRILL - Demokratët në Shtetet e Bashkuara vazhdojnë presionin mbi presidentin Donald Trump, edhe pas publikimit të raportit për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e vitit 2016. Ata duan që Robert Mueller, këshilltari i posaçëm që ka hartuar raportin, të dëshmojë publikisht përpara Kongresit për punën që ka bërë. Mueller konfirmoi gjetjet e inteligjencës amerikane se Rusia ka ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016 që i ka fituar Trumpi dhe dokumentoi përpjekjet e presidentit për të minuar hetimin e tij. Por, Mueller nuk tha se Trumpi ka bashkëpunuar me zyrtarët rusë.

Gjetjet e tij u detajuan në një raport 448 faqesh, pjesërisht të redaktuar, që u publikua të enjten. Ky raport, po ashtu, nxori në pah fushat ku Trumpi dhe bashkëpunëtorët e tij mund të përballen ende me probleme ligjore.

Raporti u mirëprit nga Trumpi, i cili rikujtoi deklaratat e tij se ai dhe bashkëpunëtorët e tij as nuk kanë bashkëpunuar me zyrtarët rusë, as nuk kanë bërë

përpjekje të pengonin hetimet. Duke folur në një ngjarje për veteranët, Trumpi tha se po kalon një "ditë të mirë", duke shtuar se nuk ka pasur "asnjë bashkëpunim" me Rusinë dhe as pengim të drejtësisë. Publikimi i raportit myll një kapitull të hetimeve që hodhi hije mbi presidencën e Trumpit, madje edhe përpara se të merrte detyrën. Megjithatë, udhëheqësit demokratë të Kongresit, Nancy Pelosi dhe Chuck Schumer, përmes një deklaratë të përbashkët, thanë se raporti paraqet "një imazh shqetësues të një presidenti me një varg mashtrimesh, gënjeshtresh dhe sjelljesh të pahijshme". Ata, po ashtu, thanë se "Kongresi duhet të vlerësojë sjelljen e padrejtë, korruptive dhe imorale të presidentit, në përpjekje për të penguar hetimet".

Demokrati numër dy i Dhomës së Përfaqësuesve, Steny Hoyer, tha se nxjerrja e presidentit në votëbesim nuk ia vlen, pasi zgjedhjet e reja presidenciale do të mbahen në nëntor të vitit të ardhshëm. "Bazuar në atë që kemi parë deri më tash,



votëbesimi nuk ia vlen. Zgjedhjet do të mbahen pas 18 muajsh dhe populli amerikan do të gjykojë", tha Hoyer për CNN-in.

Përfaqësuesi demokrat, Jerrold Nadler, kryetar i Komitetit për Drejtësi në Dhomën e Përfaqësuesve, kërkoi që Kongresi të ketë raportin e plotë, të paredaktuar të Muellerit. "Këshilltari i posaçëm e bën të qartë se nuk e ka shfaqësuar

presidentin dhe tani përgjegjësia është te Kongresi, për ta bërë presidentin përgjegjës për veprimet e tij. Kongresi duhet ta ketë raportin e plotë, të paredaktuar, së bashku me provat e mbledhura nga këshilltari i posaçëm, Mueller", tha Nadler. Përpara publikimit të raportit, prokurori i përgjithshëm i SHBA-së, William Barr, mbajti një konferencë për media në Uashington, ku dha detaje mbi

raportin. Barr tha se hetimet nuk kanë gjetur prova se Trumpi ose anëtarët e fushatës së tij kanë bashkëpunuar me përpjekjet e Rusisë për të ndërhyrë në zgjedhje.

Barr, i cili ka publikuar një përmbledhje prej katër faqesh të raportit në fund të muajit të kaluar, po ashtu tha se raporti i Muellerit nuk paraqet asnjë dëshmi se Trumpi ka bërë përpjekje të pengojë drejtësinë.

## Anulohen bisedimet për paqe në Afganistan

KABUL, 19 PRILL - I dërguari i Kombeve të Bashkuara për Afganistanin, Zalmay Khalilzad, shprehu zhgënjimin e tij për shtyrjen e bisedimeve të paqes, të cilat ishin planifikuar të mbahen në fundjavë midis talibanëve dhe një delegacioni të madh të afganëve. Rreth 250 politikanë afganë dhe figura të shoqërisë civile është dashur të takohen me negociatorët talibanë në Doha.

Bisedimet janë parë si hapi i parë i rëndësishëm drejt gjetjes së një zgjidhjeje të negociuar për t'i

dhënë fund luftës gati 18-vjeçare në Afganistan dhe për tërheqjen e trupave amerikane nga ky vend. Por, takimi u anulua papritmas për shkak të mosmarrëveshjeve rreth madhësisë dhe përbërjes së delegacionit afgan, që përfshinte disa zyrtarë të Qeverisë afgane, të cilët synonin të merrnin pjesë në kapacitet personal.

Talibanët kritikuan listën e gjatë të delegacionit afgan, duke thënë se nuk do të takohen me kaq shumë njerëz. Talibanët, gjithashtu, thanë se nuk do të negociojnë me anë-

tarët e Qeverisë afgane. Militantët, deri më tash, kanë biseduar vetëm me përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara, duke i konsideruar ata si "armiqtë" kryesorë. Ata kanë refuzuar të bisedojnë me Qeverinë në Kabul, pasi, sipas tyre, ajo është "kukull" e SHBA-së.

Shtetet e Bashkuara kanë ndërhyrë ushtarakisht në Afganistan në vitin 2001, pak kohë pasi militantët të lidhur me grupin terrorist Al Kaida kanë kryer sulme terroriste në tokën amerikane, duke vrarë mbi 3,000 njerëz.



Ndërhyrja e SHBA-së dhe aleatëve të tjerë të NATO-s ka rrezuar

talibanët nga pushteti në Afganistan në vitin 2001.

# ORGANIZATA PATRIOTIKE ILEGALE 'PARTIA E LUFTËS E KOSOVËS'



**Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA**

Pas vitit 1983 organet e sigurimit dhe të pushtetit okupues menduan se ilegale shqiptare e kishin asgjësuar tërësisht. Mirëpo, edhe pse ishin mbajtur një numër i madh i proceseve gjyqësore dhe ishin zbuluar shumë grupe e organizata, asnjëherë nuk kishte ndodhur që të zbuloheshin të gjithë anëtarët e grupeve. Këtë e dëshmon viti 1984. Organet e sigurimit zbuluan dy organizata dhe 12 grupe ilegale me mbi 300 anëtarë, prej të cilëve penalisht e për kundërvajtje u ndoqën 173 persona, kurse 48 personave iu tërhoq vërejtja. Të gjitha grupet dhe organizatat që u zbuluan kishin një vazhdimësi të mëhershme, që para viteve 1980/1981. Kjo e dëshmon atë që u tha më lart.

Në dokumentin P-K-108/84, në aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, thuhej se Kadri Osmani, pas mbajtjes së dënimit në burgun e Dobit, gjykuar nga neni 117 al. 1. të KP-së, si njëri nga udhëheqësit e organizatës ilegale "Grupi Revolucionar", sapo kishte dalë prej atje, kishte kërkuar lidhje të tjera për të vazhduar veprimtarinë patriotike. Së këndejmi rridhte frika e pushtet mbajtësve nga recidivët politikë. Këtyre ua kishin frikën më të madhe. Këta persona kishin përvojë ilegale, kishin njohuri të duhura, kishin guxim dhe, mbi të gjitha, kishin besim te të tjerët.

Kadri Osmani nuk kishte qenë pasiv as gjatë qëndrimit në burg. Atje bisedonte me të burgosur të tjerë, matë pulset e tyre dhe, aty ku shihte se kishte gjasë për ta përfituar një anëtar të devotshëm të ilegales, pa përtesë fillonte punën. Kështu ndodhi me të burgosurin Avdullah Rustolli, i cili po ashtu gjendej në burgun e Dobit. Një kohë të gjatë Kadri Osmani i tregoi për jetën ilegale në Kosovë, për padrejtësitë e shumta që i bëheshin popullit shqiptar etj., derisa një ditë e bindi që të organizohej dhe të bëhej anëtar i organizatës ilegale.

Më 1977 ai para tij e ka dhënë betimin për besnikëri: "Se do të

jetë besnik, se detyrat e parashtruara do t'i kryejë me ndërgjegje, se do ta ruajë fshehtësinë, se shokët me të cilët punon nuk do t'i zbulojë etj". Pas daljes nga burgu, Avdullah Rustolli, duke i qëndruar besnik betimit të dhënë, gjatë pushimeve në Ulqin formoi "treshen" e organizatës, duke angazhuar edhe Isak Havollin dhe Bajram Ajetin, të cilët e dhanë betimin para Avdullah Rustollit, sipas tekstit që e kishte përpiluar shumë më herët Kadri Osmani. Anëtarëve të rinj iu caktuan detyrat. P. sh., Bajram Ajeti e mori përsipër që në trevën e Llapit të formonte "treshë" të reja.

Pas nëntë vjetësh burg, Kadri Osmani kërkonte lidhjet e vjetra me bashkëmendimtarët e vet. Xhafer Shatri kishte ikur në Zvicër, ku kishte formuar organizatën e re me emrin "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi".

Avdullah Rustolli u angazhua që të shkonte në Zvicër dhe të binte në kontakt me Xhafer Shatrin e me Hasan Malën dhe t'i njoftonte ata se si do ta fillonin aktivitetin e serishëm në vend.

Më 1983, Kadri Osmani njoftohet se Sejdi Veseli i takon organizatës ilegale "Fronti Nacionalçlirimtar i Kosovës". Ai takohet edhe me anëtarët udhëheqës të "Frontit", mban disa takime me ta, njoftohet me punën që kryen kjo organizatë, njëherësh njoftohet se kjo organizatë u dërgon materiale ultimative organeve udhëheqëse të krahinës si dhe funksionarëve të caktuar politiko-shoqërorë, që nëse Kosovës gjer më 1 janar 1984 nuk i jepet statusi i Republikës, atëherë "Fronti NÇ i Kosovës" do të ndërmerret masa adekuate e konkrete për realizimin e saj".

**Më 17 qershor 1984 u nxorën para Gjyqit të Qarkut në Prishtinë 14 veta, anëtarë të Organizatës "Partia e Luftës së Kosovës"**

Kjo organizatë kishte "Komitetin Qendror" dhe kryesinë e saj. Sejdi Veseli ishte sekretar i përgjithshëm i "FNÇK"-së. Ndërkohë u morën vesh që në të ardhmen organizata të quhej "Fronti Antirevizionist" dhe njëherësh të formoheshin "Shtabet Operative", si: "Shtabi Operativ Shkencor" (SHOSH), që do të jetë organi më i lartë i "Partisë së Luftës së Kosovës". U shtrua nevoja që

ato të formoheshin në qendër të Kosovës, prej tre anëtarësh, që kombëtarisht ishin të ngritur dhe ishin me fakultete të kryera. Nga çdo SHOSH do të dërgohej nga një anëtar për kongres, që llogaritej të mbahej në gjashtëmujorin e parë të vitit 1984. Planifikohej që të formoheshin edhe "Shtabet Operative Qarkore" (SHOQ). Ato mendohej të formoheshin në çdo lokalitet të Kosovës dhe në çdo organizatë më të madhe punuese dhe të kishin nga tre anëtarë që kishin të mbaruara së paku shkollat e larta. Ndërkaq, "Shtabet Operative Rajonale" (SHOR), ishin paraparë që të kishin nga tre anëtarë, me shkolla të mesme të mbaruara. Nga këto shtabe ishte paraparë që të formoheshin "Njësite Guerile", ose "Brigada Sulmuese", të dedikuara për aksione konkrete, për shpërndarjen e parullave, të trakteve, të materialeve propaganduese, e në rast nevojë edhe për luftë. Në një mbledhje të mëvonshme, që mbahet në shtëpinë e Sejdi Veselit, në të cilën marrin pjesë Kadri Osmani, Sejdi Veseli, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, shumëzohet materiali "Programi Nacionalçlirimtar i Kosovës", që është themeluar në "Mbledhjen e 28 Nëntorit 1980" në Prishtinë, ku është marrë vendim që të nxirret edhe një gazetë me titull "Revolucioni i Kosovës", që do të jetë organi i "Partisë së Luftës së Kosovës", së cilës do t'i paraprijnë fjalët e betimit: "Betohem para klasikëve të marksizëm-leninizmit, Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe Enver Hoxhës si dhe para flamurit kombëtar e para shokut (shokëve) se gjithë jetën do t'ia kushtoj çështjes sonë: bashkimin kombëtar dhe territorial, betohem se do të mbaj konspir-

acion të thellë dhe se për asnjë grimë nuk do t'i tejkalojë autorizimet e dhëna dhe nëse tradhtoj mos i shpëtoftsha dorës së pamëshirshme të popullit". Është me interes që të cekët se gjatë veprimtarisë së organizatave ilegale patriotike shqiptare në Kosovë, tek teksti i betimeve vërejmë evoluime të pjesshme, por asnjëherë pa ndryshuar qëllimin e organizatës. Teksti i betimeve përpilohej edhe në bazë të situatave politike në Shqipëri por edhe në ish-Jugosllavi. Por, ajo që ishte më e rëndësishmja është se, në çdo tekst të betimit, flamuri kombëtar shqiptar dhe bashkimi i trojeve shqiptare është bazament dhe qëllimi suprem i çdo organizate pa marrë parasysh emërtimin ideologjik të saj. Andaj, nuk është për tu çuditur pse është ky tekst i betimit, ngase në atë kohë Shqipëria ishte vend komunist dhe nga ajo normalisht, pritej përkrahja për organizatat patriotike në Kosovë.

Më 1983, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha me pasaporta false donin ta kalonin kufirin ilegalisht dhe anëtarët e organizatës ilegale që vepronte në Perëndim t'i njoftonin me punën e tyre dhe me kërkesën e tyre, jo vetëm me kërkesën "Kosova-Republikë", por edhe me ndryshime të tjera radikale që do të ndodhin në vend. Mirëpo, për tërë këtë nevojitej një veprimtari paksa më e zgjeruar. Duhej organizuar greva, demonstrata, duhej përgatitur materiale propaganduese, trakte, fletushka, parulla dhe këto duhej shpërndarë në vende të ndryshme. Po qe se paraqitet nevoja, duhet ndërmarrë edhe aksione konkrete, edhe me armë, në mënyrë që të jepet shkas që Kombet e Bashkuara të ndërhyjnë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Në periudhën kohore qershor-

dhjetor 1983, kjo organizatë u furnizua me shumë materiale që sillleshin ilegalisht nga perëndimi në vend. U sollën: "Zëri i Kosovës", "Zëri i atdheut", libri "Titistët", "Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë", "Trakti kundër tradhtisë", udhëzimi "Si të mbrohem para organeve të sigurimit" dhe këto materiale iu shpërndanë anëtarëve më të besuar të organizatës. Organizata kishte fondin e vet, i cili mjetet materiale i siguronte nga anëtarësia si dhe nga donacionet e ndryshme, si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda.

Organizata "Partia e Luftës e Kosovës" ishte organizatë e cila vepronte në bazë të platformës së "Lëvizjes së Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi". Kryesisht vepronte në rajonin e Prishtinës, të Podujevës, të Ferizajt, të Lipjanit dhe të vendeve të tjera në Kosovë.

Në komunën e Ferizajt vepronte treshja e përbërë nga Ibush Vishi, Enver Topalli dhe Agim Vishi. Më 1983, në qershor, u bashkëngjitet edhe ilegalisti i njohur, Ramë Buja. Këta në mënyrë të organizuar shpërndajnë "Traktin kundër tradhtisë", të cilin nëpërmjet postës ua dërgojnë personave të ndryshëm në komunat Ferizaj, Kamenicë, Gjilan, Istog dhe Pejë. E tërë kjo bëhet me qëllim që masat e gjera të përgatiteshin, se më vitin 1984 llogaritej që të mbaheshin demonstrata masive popullore. Në Komunën e Podujevës ishin dhënë 18 "Trakte kundër tradhtisë", 15 numra të gazetës "Zëri i Kosovës", nr. 2 e 3, dy libra "Titistët" dhe shumë materiale të tjera, që i kishte marrë përsipër t'i shpërndante Bajram Ajeti.

(Vijon / Fusnotat i ka hequr redaksia)



**E rrallë**

## Burri pret gishtin pasi votoi partinë e gabuar

Një votues indian ka prerë gishtin e tij tregues pasi e kuptoi se kishte votuar për partinë politike "të gabuar". Në një video që është bërë virale, Pawan Kumar thotë se ai votoi aksidentalisht për Partinë qeverisëse Bharatiya Janata (BJP). Ai donte të votonte



për një parti rajonale, por u hutua nga simbolet e shumta në makinën e votimit.

## BARSOLETA E DITËS



Njëri pyet kolegun polic:  
- Çfarë ke? Të ka ndodhur gjë?  
- Edhe po më pyet a? Nesër kam test të gjakut e nuk kam mësuar asgjë.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

#### “HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



**FOTO E DITES**



Pllakat diellore në termocentralin e Francës juglindore. /AFP/

Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

#### “THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

#### “CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

#### “U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award®-winning visionary Jordan Peele



**E jashtëzakonshme**

## Gjarpërinjtë detyrojnë presidentin të largohet nga zyra

Dy gjarpërinj kanë detyruar presidentin e Libisë, George Weah, të dalë nga zyra dhe të punojë në banesën private. "BBC" ka raportuar se dy



gjarpërinjtë u gjetën të mërkurën në ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, vendi zyrtar i punës së presidentit.

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Tensione në vendin tuaj të punës që nuk ju lënë rehat. Por, nga ana sentimentale gjithçka shkon mirë dhe partneri është mbështetësi juaj kryesor.</p>	 <p><b>DEMI</b> Në ambientet që frekuentoni vazhdimisht do të gjeni njerëz që ndajnë të njëjtat ide si ju. Bashkë mund të bënit një skuadër fituese në çdo gjë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot jeni i justifikuar nëse shpenzimet tuaja kanë për qëllim dhuratat për personat e dashur. Gjithmonë ju kanë akuzuar se jeni egoist në shpenzime.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Fantazia e shfrenuar sot do t'ju ndihmojë të harroni për pak çaste problemet që ju kanë mbushur ditën. E keni gjetur si rrugë shpëtimi këtë gjë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot, edhe pse nuk keni qejf të punoni, shumë alternativa interesante do të zgjojnë tek ju ambicien e dikurshme. Do t'i tregoni vetes që ia dilni me pak punë.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Edhe pse në familje ka debate ju do të dini se si ta riktheni harmoninë e dikurshme, çdo gjë do të qetësohet gjatë pjesës së dytë të ditës.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sonte nuk keni pse të mërziteni sepse keni marrë disa ftesa shumë interesante. Ju mjafton vetëm të zgjidhni se ku do të shkoni.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Argëtohuni sot duke hequr mendjen nga gjithçka që ju ka shqetësuar kohët e fundit. Miqtë do të dinë se si t'ju bëjnë t'i harroni problemet.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Disa keqkuptime të vogla do ta ndryshojnë komplet thelbin e bisedës sot. Nuk do të jeni në gjendje të sqaroni atë çka donit të thoshit.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Këshillat e mira merren gjithmonë në konsideratë. Këtë do të bëni edhe ju sot sepse e dini mjaft mirë që personat që po jua japin jua duan të mirën.</p>	 <p><b>UJORI</b> Doni të niseni sa më parë në udhëtimin që keni planifikuar dhe dita e sotme ju favorizon për këtë gjë. Shijoni çastet larg punës suaj.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të korrighoni disa veprime të nxituara që keni marrë në të shkuarën. Janë gjëra që mund t'ju prishnin shumë punë nëse nuk zgjidheshin.</p>


## Jason Momoa rruan mjekrën pas shtatë vjetëve



Aktori i famshëm, Jason Momoa, ka rruar mjekrën e tij për herë të parë që nga viti 2012. Momoa këtë vendim e mori për arsye se është duke e mbështetur

kampanjën e ujit "Ball Corporation". Me anë të kësaj kampanje janë duke u lansuar shishet e ujit që janë 100 për qind të riciklueshme dhe nuk dëmtojnë natyrën.

## Shawn Mendes tregon sekretin e bukurisë



Këngëtari i famshëm botëror, Shawn Mendes, ka thënë se nuk e pastroft fytyrën shpesh. I pyetur se cili është sekretin e bukurisë për shkak se ai çdoherë e ka fytyrën shumë të pastër, Mendes ka shkruar në

"Twitter. "Unë nuk ju gënjej juve kur them se nuk e pastroj shpesh fytyrën. Unë mendoj se një lëkurë e mirë është e bazuar dhe reflekton nga ajo se si ndiheni. Nëse jeni i lumtur do ta keni edhe fytyrën e bukur", ka thënë Mendesi.

## Vëllezërit Jonas po rikthehen në skenë



Vëllezërit Jonas po kthehen në skenë. Të tretë do të performojnë në Billboard Music Awards 2019 më 1 maj në orën 20:00. Lajmin e kanë konfirmuar drejtuesit e shfaqjes. Grupi

do ta këndojë këngën "Sucker". Artistë të tjerë të cilët do të performojnë në këtë ceremoni përfshijnë BTS, Halsey, Kelly Clarkson, Lauren Daigle, Khalid, Sam Smith dhe Normani.



## Charlize Theron: 'Kur fëmija im shkoi 3-vjeç, kuptova që s'ishte djalë'

Në një intervistë për Daily Mail, Charlize Theron u shpreh se po e rrit fëmijën e saj të parë si vajzë, ndonëse ia prezantoi botës si djalë. Aktorja deklaroi se shtatëvjeçari Jackson – një nga dy fëmijët e adoptuar të saj – ishte tre vjeç kur i tha: "Nuk jam djalë". "Deri në atë moment, unë e konsideroja si djalë. Kur më tha që jam vajzë, mendova që prej tani e tutja kam dy vajza. Si çdo prind, dua që t'i shoh të lumtura." Jackson është djalë fizikisht, por ndihet dhe vishet si vajzë. "Nuk e vendos unë si ndihen. Fëmijët e mi janë të lirë të jenë vetvetja. Detyra ime si prind është t'i siguroj gjithçka që kanë nevojë për të qenë gjithë ç'duan të jenë." Charlize e adoptoi Jackson-in në



vitin 2012, ndërsa 3 vite më vonë adoptoi vajzën tjetër. Kjo nuk është hera e parë që aktorja shprehet se ka dy vajza. Gjatë një interviste në dhjetor të vitit 2018, ajo i tha aktorit Michael B. Jordan se "ka dy vajza të bukura afro-amerikane".

## Pse u arrestua Kodak Black?

Reperi Kodak Black u arrestua për drogë dhe armë derisa po përpiqej të kalonte nga Kanadaja në Shtetet e Bashkuara. Policia ka njoftuar se ai ishte midis tre personave të mërkurën në një makinë të tipit "Escalade Cadillac", ngjyrë të zezë, në të cilën u gjet marijuanë dhe pistoletë Glock 9mm. Përveç akuzës për posedim të drogës dhe armëve, ai përballet me një akuzë në Karolinën e Jugut për sjellje të keqe seksuale, nën dyshimin se dhunoi një grua pas një koncerti në vitin 2016.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**

TEL: 045 82 82 82

# Prishtinës i kryen punë vetëm fitorja, Gjilanit barazimi

Leotrim Bekteshi ka paralajmëruar se Prishtina në Gjilan udhëton për fitore sepse është e vetmja rrugë që e dërgon drejt titullit kampione në elitë, kurse Hajdari nuk beson se Gjilani do të pësojë humbje nga skuadra kryeqytetase. Të shtunën në Skenderaj zhvillohet edhe ndeshja në mes të Drenicës dhe Llapit



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 19 PRILL** - Gjilani dhe Prishtina janë dy skuadrat që do të përballen sot (e shtunë) në kuadër të IPKO Superligës së Kosovës. Këto dy skuadra kanë synime të kundërta në këtë edicion, pasi gjilanasit synim kanë mbetjen në elitë, kurse kryeqytetasit të triumfojnë në garën për titull.

Mbrojtësi Leotrim Bekteshi përfaqëson zyrat e klubit "bardhekalter" ka thënë se fitorja është opsioni i vetëm për Prishtinën në këtë ndeshje. "Me gjithë ndryshimet në skuadrën e Gjilanit, mund të them se e njoh mirë ish-skuadrën time. E çmoj si skuadër të mirë dhe të fortë. Ne jemi në formë të lartë dhe të motivuar qindpërqindtë, pra jam shumë i sigurt se do ta vazhdojmë serinë e fitoreve deri në fund të kampionatit, pasi nuk kemi rrugë tjetër që na sjell te suksesi ku dëshirojmë", ka thënë Bekteshi. Skuadra e Prishtinës në këtë

ndeshje nuk do ta ketë përkrahjen e "Plisave", pasi Polica e Kosovës ka vendosur që ata mos të udhëtojnë në Gjilan, me arsyen e mungesës së sigurisë, për faktin se stadiumi është duke u rinovuar.

Prishtina e mposhti KEK-un (1-0), në ndeshjen e fundit, kurse Gjilani pësoi humbje nga Llapi (2-1), edhe përkundër paraqitjes së mirë. Sulmuesi Fiton Hajdari ka thënë për "Epokën e re" se ndaj Prishtinës synim i Gjilanit është rezultati pozitiv. "Ne jemi përgatitur maksimalisht gjatë gjithë javës për këtë ndeshje derbi dhe atmosfera në ekip është shumë e mirë. Normalisht se do të japim si skuadër maksimumin dhe në fund besoj se do të marrim një rezultat pozitiv", ka deklaruar Hajdari. Përveç ndeshjes Gjilani - Prishtina, sot zhvillohet edhe ndeshja në mes të Drenicës dhe Llapit, kurse të dielën zhvillohen dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje, e cila përfundon të hënën me dy ndeshjet që zhvillohen në Ferizaj dhe Prizren.

## IPKO SUPERLIGA

Të shtunën takohen:  
15:00 Gjilani - Prishtina  
15:00 Drenica - Llapi

Të dielën takohen:  
15:00 Drita - Trepça '89  
15:00 KEK-u - Feronikeli

Të hënën takohen:  
16:00 Ferizaj - Flamurtari  
16:00 Liria - Ballkani

## LIGA E PARË

Të shtunën takohen:  
Istogu - Drenasi  
Vitia - Onix  
Trepça - Ramiz Sadiku

Të dielën takohen:  
Besa - Dukagjini  
Vushtrria - Fushë-Kosova  
Kika - Arbëria  
Bashkimi - 2 Korriku  
Vllaznia - Vëllaznimi  
(Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 15:30)

## Sot superderbi Besa - Kastrioti

**PEJË, 19 PRILL** - Pas pushimit për shkak të aktiviteteve të shumta të ekipeve përfaqësuese, rikthehen ndeshjet e Superligës për javën e 25-të. Sot (e shtunë) e gjithë vëmendja do të jetë në Pejë ku zhvillohet superderbi në

mes të skuadrave Besa Famgas e Kastrioti. Bëhet fjalë për dy skuadrat që janë në pozitë e para me nga 44 pikë. Të gjitha ndeshjet e këtij edicioni mes Besës e Kastriotit ishin cilësore, të forta dhe dramatike. Kështu

pritet të jetë edhe këtë herë në "Karagaçi", ndërsa pritët të ketë edhe shumë shikues. Sot nga ora 18:00 zhvillohet edhe ndeshja Drita - Vushtrria. Dy ndeshjet e javës së 23-të të Superligës B janë të dielën: Zhegra -

Samadrexha (17:30), Drenica - Trepça (18:00). Në Ligën e Parë të hendbollistëve është java e 14-t. Ndeshjet luhen të dielën: Deçani - Ulpiana (12:00), KEK-u - Prizreni (12:30), Dukagjini - Llapi (14:00).



## SHKURT

### Prishtina, fituese e turneut "Shkëlzen Haradinaj"

Në Prishtinë është mbajtur Turneu Memorial Tradicional në Futsall kushtuar heroit të kombit Shkëlzen Haradinaj. Në këtë turne morën pjesë katër ekipe: Malisheva, Prishtina, Besa dhe Peja. Ndeshjet ishin mjaft interesante dhe rivalizuese. Në fund fitores iu gëzua ekipi i Prishtinës, që në finale e mundi Pejën me rezultat 5-4. Në gjysmëfinale Prishtina ishte më e mirë se Besa, të cilën e mundi 3-1, kurse Peja e mundi Malishevën 2-3.

### Cana: Reja, trajner me përvojë të madhe

Ish-kapiteni i ekipit kombëtar të Shqipërisë, Lorik Cana, e ka lavdëruar trajnerin e ri të kuqezinjve, Edoardo Rejan, me të cilin kishte punuar gjatë kohës sa ishte pjesë e Lazios. Reja kishte qenë trajner i Lazios gjatë viteve 2010-2012 dhe përsëri në vitin 2015. Pikërisht gjatë asaj kohe Cana e pati mundësinë ta shikonte nga afër punën e Rejes, pasi ishte pjesë e skuadrës së Lazios në vitet 2011-2015. "Edoardo Reja është një trajner me përvojë shumë të madhe. Me shumë mundësi, një nga trajnerët që besoj se ka moshën më të madhe jo vetëm në Itali, por në mbarë futbollin", ka deklaruar Cana për "Tring Sport". "Mirëpo, kjo pjesa që nuk ka absolutisht asnjë lloj përvojë, përveç kampionatit italian, ngre pak pikëpyetje. Reja është një person që e njeh mirë futbollin dhe shpresojmë që të arrijë të marrë më të mirën nga ky ekip", ka shtuar Cana.

### Dënohen dyshja Kessie-Bakayoko

Dyshja e Milanit, Franck Kessie dhe Tiemoue Bakayoko, raportohet se janë dënuar me 86 mijë euro, por s'do të hapen hetime për thirrjet raciste të Lazios. Sipas medieve italiane, Milani dhe të dy lojtarët kanë pranuar këtë dënim. Kjo gjobë vjen pasi Kessie dhe Bakayoko kishin prezantuar fanellën e Francesco Acerbit si trofe pas fitores prej 1 me 0 të Milanit ndaj Lazios.

### Mourinho këshillon Liverpoolin se si ta ndalë Messin

Trajneri Jose Mourinho e ka paralajmëruar Liverpoolin se ata nuk mund t'i qasen një për një Lionel Messit kur përballen me Barcelonën në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Trajneri portugez i ka komentuar ndeshjet e Ligës së Kampionëve në 'Russia Today', ku i ka dhënë edhe një mesazh Liverpoolit se si mund të ndalet argjentinasi Messi. "Messi po kalon një sezon fenomenal dhe me Juventusin dhe Ronaldon jashtë kësaj gare, ai e di se 'Topi i Artë' po pret për të. Messi është i lehtë për ta kuptuar, por nuk është e lehtë për ta krijuar një zonë për të kontrolluar atë, sepse ai vjen nga e majta, pastaj qëndron në mes. Është shumë e vështirë. Kur Messi ka topin, ju jeni të vdekur. Kjo është arsyeja pse kurrë nuk kam pëlqyer t'i qasemi një për një Messit. Për mesin duhet të krijoni një kafaz", ka thënë Mourinho.




## Federeri: Kjo është dhurata më e bukur që kam marrë nga Wimbledon

CYRIH, 19 PRILL - Tenisti zviceran Roger Federer ka rrëfyer se ka marrë një dhuratë të veçantë nga organizatorët e Grand Slam të Wimbledonit. Në këtë turne ai ka fituar 8 herë në karrierën e tij dhe në dy raste ka marrë si

dhuratë rrjetën e finales, ku ai ka fituar. "Gjithnjë jam munduar të marrë një souvenir nga turnetë e mi", ka thënë Federeri, fitues i 20 grand slameve në karrierën e tij. "Nuk bëhet fjalë për këpucë apo uni-

forma të turneve që fitoj, të cilët i ruaj. Në dy raste, nga Wimbledon kam marrë dhuratë rrjetën e finales ku kam fituar. E kam ende të palosur në shtëpinë time, por një ditë do të më pëlqente ta hapja dhe ta

vendosja në një mur, në mënyrë që ta shoh. Kjo është një dhuratë e veçantë, më e bukura e karrierës sime. Kam një lidhje të veçantë me këtë turne, ndaj e vlerësoj shumë atë dhuratë", ka deklaruar Federeri.



## 2 700 fëmijë shijojnë sportet në 'Fadil Vokrri'

PRISHTINË, 19 PRILL - Është mbajtur festivali i parë sportiv për Parafillorët e Komunës së Prishtinës, i cili është organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës. "Premtoj fort, do të merrem me sport" u mbajt në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, kurse pjesëmarrës ishin rreth tre mijë fëmijë. Qëllimi i këtij festivali është masivizimi i sportit dhe joshja e fëmijëve për t'u marrë me sport. "KOK-u organizon festivalin Sportiv për Parafillorët e Prishtinës për vitin 2019. Ky organizim po bëhet në kuadër të ditës së sportit për zhvillim dhe paqe", ka thënë Shasivar Haxhijaj, sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës. Në hapje të festivalit kanë qenë të pranishëm kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri për Kulturë, Rini dhe Sport, Kujtim Gashi. Duke iu drejtuar sportistëve të vegjël, të pranishëm në këtë ceremoni, kryeparlamentari Veseli paralajmëroi investime edhe më të mëdha në sport dhe infrastruk-




turen përcjellëse. "Ju jeni kampionët e ardhshëm të Kosovës. Jeni pasardhësit e Adem Jasharit, të kampiones Majlinda Kelmendi e shumë kampioneve të tjerë nga të gjitha disiplinat sportive. Kosova është e bekuar që ju ka juve. Do të investojmë edhe më

shumë në sport, në stadione të bukura anekënd Kosovës", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Fëmijët kishin rastin që për herë të parë ta shpalosin talentin e tyre në futboll dhe disiplinat e atletikës si: vrapim, kërcim dhe hedhje të gjyles së imituar.

## Golden State u hakmerret Clippersave, fitojnë lehtë Spursi dhe Philadelphia

OAKLAND, 19 PRILL - Golden State merr sërish epërsinë në çerekfinalin e "play-off-it" të Konferencës së Perëndimit në përballjen ndaj Clippersave duke fituar 132-105 në ndeshjen e tretë. Sfidën e luajtur në Los Anxhelos u dominua nga skuadra kampione e NBA-së, që u hakmor për humbjen e tri ditëve më parë. Duranti me 38 pikë ishte në një mbremje magjike, mbështetur edhe nga Curry me 21 pikë. Për Clippersin u dallua Zubaq me 18 pikë e 15 rebounde, por që mbetën për statistikë. Warriorsi udhëhoqi 2-1 me ndeshje. Po 2-1 me ndeshje udhëheq edhe skuadra e San Antonios, që përfitoi nga faktori fushë për ta mundur 118-108 Denverin, në çerekfinalin e tretë mes tyre në Perëndim. Sfidë e komanduar në shumicën e kohës nga Spursi që vetëm në periodën e dytë pati probleme. Në periodën e katërt, skuadra teksane u shkëput dhe dominoi lojën falë Whites, që realizoi 36 pikë, ndërsa DeRozani e mbylli me 25 pikë. Në Lindje, ekipi i Philadelphia triumfoi 131-115 ndaj Brooklynit në përballjen e



tretë mes tyre, duke udhëhequr 2-1 me ndeshje. Skuadra mike pati një avantazh prej 10 pikësh gjatë gjithë kohës, duke e ruajtur atë deri në fund. Simmons me 31 pikë e Harris me 29 pikë

e 16 rebounde ishin më të mirët në fushë për Philadelphian. Në kahun tjetër, Russell dhe LaVerti realizuan nga 26 pikë secili, por që s'mjafuan.

### KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

1-8 Milwaukee - Detroit		(2-0)
4-5 Boston - Indiana		(2-0)
3-6 Philadelphia - Brooklyn	131-115	(2-1)
2-7 Toronto - Orlando		(1-1)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

1-8 Golden State - Clippers	132-105	(2-1)
4-5 Houston - Utah Jazz		(2-0)
3-6 Portland - Oklahoma		(2-0)
2-7 Denver - San Antonio	108-118	(1-2)

### SHKURT

#### Messi, lojtari i javës në Ligën e Kampionëve

UEFA ka shpallur lojtarin e javës, duke u bazuar në performancat e bëra në katër ndeshjet e dyta çerekfinale, me Lionel Messin që ka dalë triumfues, duke lënë pas De Ligt apo Son. Argentinasi ishte protagonist kryesor mbremjen e së martës, teksa shënoi një dopietë ndaj Manchester Unitedit. Shtatë ishin gjuajtjet e "pleshtit", teksa e preku plot 106 herë topin në atë takim. Gjithashtu, Mesi kontribuoi me 78 pasime, me një saktësi prej 86 %.

#### Allegri: Ronaldo, e ardhmja e Juves

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, ka siguruar tifozët e "Zonjës së Vjetër" se Cristiano Ronaldo nuk do të largohet, por përkundër e ka quajtur si të ardhmen e Juventusit. "Ka bërë sezon të madh dhe do të luajë titullar të shtunën. Ronaldo është e ardhmja e Juventusit, është lojtar që do të bëjë sërish sezon të madh vitin tjetër. E shoh të qetë, normalisht i zhgënjyer si të gjithë ne për shkak të eliminimit nga Liga e Kampionëve, sepse donim ta fitonim", ka thënë Allegri.

#### Ancelotti: Ndaj Arsenalit loja zgjati vetëm 30 minuta

Napoli është eliminuar nga Liga e Evropës, pasi pësoi humbje edhe në ndeshjen e dytë nga Arsenali. Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se skuadra e tij luajti mirë vetëm në 30 minutat e parë. "Loja zgjati vetëm 30 minuta, ku bëmë shumë mirë por, pas golit të tyre, ndeshja mbaroi. Ishte normale, pasi na duhej të shënonim 4 gola, për të vijuar më tej dhe kjo minimizoi besimin te futbollistët e mi. Provuam të bëjmë diçka në fillim dhe krijuam disa raste, por nuk i shfrytëzuam. Në të tilla çaste, është e rëndësishme që episodet t'i kesh në favor", ka deklaruar Ancelotti.

#### Dzeko refuzon West Hamin, preferon Interin


Sulmuesi Edin Dzeko e ka refuzuar ofertën e West Hamit në kampionatin anglez, pasi shpreson që t'i bashkohet Interit gjatë verës. Mediet italiane bëjnë me dije se sulmuesi boshnjak u ka kërkuar menaxherëve të tij, që të mos negociojnë me West Hamin, pasi ka të tjera synime. Në Itali emri i Dzekos lakohet si njeriu që do të zëvendësojë Mauro Icardin në sulmin e Interit, duke filluar nga sezoni i ardhshëm.

#### 'Marca': Hazardi shumë shpejt zyrtarizohet te Reali

Eden Hazard do të jetë blerja e tretë e Realit të Madridit për sezonin 2019-2020 pas Rodrygos dhe Militaos. E përditshmja "Marca" raporton se marrëveshja me futbollistin belg do të zyrtarizohet në ditët në vijim. Mes palëve ka një marrëveshje të avancuar, e përpiluar pas shumë muajsh bisedime intensive. Po sipas kësaj gazete prestigjioze, Chelsea do të përfitojë rreth 100 milionë euro nga ky transferim. 28-vjeçari mësohet se ka refuzuar tri ofertë të drejtuesve të bluve të Londrës për rinovimin e kontratës, pasi dëshiron të çdo kusht t'i bashkohen Realit të Madridit, nën urdhrat e Zinedine Zidane. Deri në mbyllje të sezonit Hazardi ka premtuar se do ta bëjë të pamundurën për ta dhënë kontributin e tij në arritjen e objektivit të mbetur: kualifikimit në Ligën e Kampionëve nëpërmjet Premierë Ligës dhe fitimit të Evropa Ligës.

#### Gjashtë lojtarë pritet të largohen nga Juve

Juventus është eliminuar nga Liga e Kampionëve, kurse këtë fundjavë do ta festojë titullin në Serinë A. "SportMediaset" raporton se në këtë klub pritet të bëhen shumë ndryshime gjatë afatit kalimtar të verës, kurse gjashtë lojtarë do të largohen nga Torino. Në përjashtim të Andrea Barzagli që ka paralajmëruar pensionimin, pesë lojtarë e tjerë që do të kërkojnë angazhim në ndonjë klub tjetër janë: Paulo Dybala, Douglas Costa, Miralem Pjaniq, Alex Sandro dhe Martin Caceres.



					<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	QË ZHVILLOHET ME FORCË E SHPEJT	E KËPUTUR; E MPAKUR	VERBAND OSTBELGIS. RADSPORTLER	AKTORI REXHEPI	KOMIKU I SHQUAR ... CARREY (origj.)	I GJYMTOVA	TRAJNERI ISMET ..... (LLAMKOS KOSOVA)	<b>EPOKA E RE</b>	ZANORE	QËLLIM I PARAMENDIM	NUMËR THEMELOR
					SHMANGIE								VEPËR E KRYER, PUNË SHKRIMTARI GJERMAN ERIK MARIA			
					SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR									DUKAT		
					SHKRIMTARJA KAMBERI									SELEN KALIBRI I TYTËS SË ARMËS		
					ADRIAN KRASNIQI			BASHKËT. FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO		VLERË, DOBI (krah.) BASHKËT.						DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME
					AKTORJA E FAMSHME DEMI ... (shqip.)				GOCAT TITAN, LITËR						BASHKËT. PJESE ERRËT E DITËS	
					PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (vjet.)					DESPOTI PAJISJE PËR DREJTIMIN E VETURËS						
					KRUJA		RYSHFET ELEMENT KIMIK					GRUP MAFIOZ I KËTJË ÇASTI, I KËSAJ KOHE				
<b>EPOKA E RE</b>	KEQTINGËLLIM	TË FIKËT	NDËRTESE E POSAÇME KU SHFAQEN FILMA	POLITIKANI FERID	<b>EPOKA E RE</b>	PËREMËR VETOR	SHTET NË AMERIKË (pashq.) BLETA QË IKËN NGA ZGJOI I VET						TRAJNERI GJERMAN REHAGEL			
FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN LEITE ....					LAJ NË AR, PRAROJ ZANORE					KRAHINË NË SHQIPËRI PRESIDENTI AMERIKANAN ..... OBAMA			FAMË BAKRI			
LLOJ KROKODILI								BEDRI OSMANI BURNT ORANGE REPORT				FLORIRI GRUMBULLIM			SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA	FEMRA E KALIT (sh.shq.)
SHTET I MADH NË AZI					ADEM JASHARI			BIMË E VENDEVE TË NXEHTA BASHKËT.						DY BASHKËTINGËLLORE EMPOLI		
ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL (LIVERPOOL)					DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË		GAZ PËR DEZINFEKTIMIN E UJIT RILINDËSI NË FOTO .... VRETO			EMËR YNI FEMRE VETURAT, AUTOMJETET						
NJËSI E VOGËL E ORGANIZIMIT TË JETËS SHOQËRORE								POLITIKANI HARADINAJ (shq.) BERAT LUZHA						ANNA LEE TOKA E BUKËS		
OKSIGJEN, NATRIUM				SHKRONJA TË NJËJTA GOTË PREJ BAKRI			BELGJIKA EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN		THIKË QË MBEHEJ SI ARMË BREZI "I" para dy "E"				MA JEP ISH BOKSIERI LIKA (shq.)			
NAIM ISMAJLI			RRUGA E HAPUR NËN KODËR MBATHËSET SPORTIVE							BIXHOZ BASHKËT.					BASHKËT. FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN ....	
ZANORE		KRITERI PATRIOTI PRISHTINA (shq.)						SHKRIMTARI ..... ZOLA KËNGËTARJA ..... KONÇI				KAFENE, RESTORANT VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE				SHTET NË AZI ..... LINDOR
<b>EPOKA E RE</b>	KRAHINË NË KOSOVË NJËSI MATJEJE (sh.shq.)					OPEN MICROSCOPY ENVIRONMENT KOMPOZITORI KOÇI (shq.)				MARKË E VESHJEVE SPORTIVE PRIFT HEBRAIK				UGANDA, TANZANIA KËNGËTARJA JONË ..... TAKE		
LUMË NË SHQIPËRI				HUQ, VES NËNË				SHKRIMTARI HAZIRI (shq.) AKTORJA E FAMSHME ..... REID								
LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI					LETRAT ARTAN (perkdh.)							VËNIE E MINAVE BASHKËT.				
NJËRIU QË KANDONJË GJYMTYRË ME CEN A TË PARALIZUAR						KOLEGJ UNIVERSITAR NË KOSOVË ZANORE				ISH DIZENJATORI ITALIAN VERSAÇI MARC ANTHONY					ZANORE ERMELINDA MEKSI	
ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER							FUTBOLLISTI ANGLEZ FERDINAND BASHKËT.					KALORËS MESJETAR PRAGA				
KOLOSI						NDËNJËSE E GJATË KU MUND TË RRINË KATËR-PESË VETA							LLOJ VETURE FRANCEZE			



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 11 dhe 18, në bazë të Rregullores nr. 02/2010 për Rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 64 paragrafi 2 pika b, Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 01/2017, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 4, neni 9 dhe neni 11, si dhe Rregullores nr. 03/2017, për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provoese të Nënpunësve të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe vendimit nr. 268/2019 të datës 11.04.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpallë:

## KONKURS

